



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 31

Tiranë – E hënë, 9 mars 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 17/2020 datë 17.2.2020	Për produktet plehëruese..... 2729
Dekret i Presidentit nr. 11447, datë 6.3.2020	Për shpallje ligji..... 2740
Ligj nr. 22/2020 datë 5.3.2020	Për disa shtesa në ligjin nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar” 2740
Dekret i Presidentit nr. 11448, datë 6.3.2020	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 2746
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 190, datë 4.3.2020	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Bashkëpunuese të Guajanës, për përjashtimin nga kërkesat për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, pasaportave të shërbimit dhe pasaportave të zakonshme..... 2747
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 191, datë 4.3.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar..... 2749
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 4.3.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 177, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ‘RSM’, në shtabin e trajnim-këshillimit dhe të ndihmës, në kuadër të iniciativës së Kartës së Adriatikut, në Afganistan” 2757
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 4.3.2020	Për miratimin e dokumentit të ndryshimit nr. 1 të kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për <i>by-pass</i> -in e Vlorës..... 2757

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 4.3.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Sistemimi i sheshit pas pallatit nr. 23”, Lushnjë.....	2761
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 4.3.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘ <i>by pass Fier</i> ’”.....	2762
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 4.3.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 245, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të Sallës së Koncerteve të Pallatit të Kongreseve, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor”, të ndryshuar.....	2776
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 4.3.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 277, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të disa objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3 035.6 m ² , brenda territorit të pronës me numër rendor 90, me emërtimin ‘Reparti ushtarak nr. 4400 (ish-Shtabi i KML-së)’, me vendndodhje në Brar, Tiranë”.....	2776
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 203, datë 26.2.2020	Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit.....	2777
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 204, datë 9.3.2020	Për marrjen e masave për ngritjen e infrastrukturës për shërbimin e karantinës dhe për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.....	2780
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 9.3.2020	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitin 2020, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga COVID-19.....	2781
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 122, datë 26.2.2020	Për miratimin e protokolleve për masat ndaj <i>Coronavirus</i> -it nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.....	2782
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 123, datë 26.2.2020	Për një shtesë në urdhrin nr. 632, datë 29.8.2018, “Për miratimin e listës së sëmundjeve infektive, të detyrueshme për t’u raportuar nga institucionet shëndetësore, publike ose private të të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë”.....	2786
Urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 142, datë 3.3.2020	Për delegim kompetencash.....	2787



LIGJ
Nr. 17/2020

PËR PRODUKTET PLEHËRUESE

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- a) garantimin e shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi i produkteve plehëruese;
- b) rritjen e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve me elemente ushqyese;
- c) përmirësimin e cilësive fiziko-kimike dhe të pjellorisë së tokës.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe organizimin e funksionimit e strukturave përkatëse.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

- a) produktet plehëruese që regjistrohen, prodhohen, eksportohen, tregtohen, importohen dhe përdoren në Republikën e Shqipërisë;
- b) personat fizikë e juridikë që ushtrojnë veprimtari të parashikuara në dispozitat e këtij ligji,

si dhe të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet, vlerësimin e ndikimit në mjedis, lejet e mjedisit e kimikatet.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ambalazhim” është një ambalazh i mbyllur që përdoret për të mbajtur, mbrojtur e për të lehtësuar shpërndarjen e produkteve plehëruese.

2. “Aplikant” është personi apo subjekti që prodhon një produkt plehëruese, që ia beson prodhimin e tij një të treti ose një personi të emëruar nga prodhuesi, si përfaqësues i autorizuar i tij, i cili paraqet kërkesë për regjistrimin e produktit plehëruese.

3. “Deklarim për produktet plehëruese” është specifikimi i përqendrimit të lëndëve ushqyese, duke përfshirë formën dhe tretshmërinë, të garantuara brenda tolerancave të përcaktuara.

4. “Dokumentacion shoqërues” është dokumentacioni që shoqëron produktin plehëruese.

5. “Elemente ushqyese” janë elementet kimike të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e bimëve, përveç karbonit (C), oksigjenit (O) dhe hidrogjenit (H), të cilët furnizohen/disponohen kryesisht nga ajri dhe uji. Elementet kimike ushqyese klasifikohen si:

a) “elemente ushqyese kryesore”, vetëm elementet azot, fosfor dhe kalium;

b) “elemente ushqyese dytësore”, elementet kalcium, magnez, natrium dhe squfur.

6. “Etiketë” është format i shkruar në letër, plastikë apo material tjetër i ngjashëm me to që i bashkëngjitet një produkti dhe jep informacion për të.

7. “Etiketimi” është vendosja e etiketës në paketimin parësor ose të jashtëm.

8. “Grupet e produkteve plehëruese” janë produktet plehëruese që kanë të njëjtin emër tipologjik, si dhe tipare e cilësi të përbashkëta mes tyre.

9. “Gjurmueshmëri” është ndjekja e një produkti plehëruese në të gjitha fazat, nga prodhimi deri te përdoruesi i fundit.

10. “Hedhje në treg” është bërja e disponueshme e produktit plehëruese në treg për



shpërndarje, konsum ose përdorim të tij gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.

11. “Heqje nga tregu” është çdo masë që synon parandalimin e të bërit të një produkti plehërues në zinxhirin e furnizimit të disponueshëm në treg.

12. “Import” është hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e produkteve plehëruese. Importi është pjesë e veprimtarisë së tregutit me shumicë.

13. “Importues” është çdo person fizik ose juridik i regjistruar në Shqipëri, i cili vendos në tregun shqiptar një produkt plehërues nga një vend tjetër.

14. “Institucioni përgjegjës” është institucioni/institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij ligji, sipas përcaktimeve të nenit 22 të tij.

15. “KRPP” është komisioni i regjistrimit të produkteve plehëruese.

16. “Korrektues” janë materialet që duhet të shtohen në tokë, kryesisht për të modifikuar e përmirësuar vetitë kimike anormale të saj, të shkaktuara nga reaksioni, kripshmëria, përmbajtja e natriumit.

17. “Laborator i akredituar” është laboratorit që ka kaluar një procedurë akreditimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e akreditimit.

18. “Laborator reference” është laboratorit i akredituar që vlerëson cilësinë e besueshmërinë e analizave të kryera nga laboratorët e miratuar dhe jep vlerësimin përfundimtar të analizave të kryera nga këta laboratorë.

19. “Laborator i miratuar” është laboratorit publik ose privat, i miratuar nga ministri, për kryerjen e analizave të produkteve plehëruese.

20. “Llojet e produkteve plehëruese” janë produktet plehëruese që përfshihen brenda një grupi.

21. “Magazinë” është objekt i veçantë që shërben për ruajtjen dhe shpërndarjen me shumicë të produkteve plehëruese të njësitë e tregutit me pakicë.

22. “Magazinim” është koha e qëndrimit të produkteve plehëruese në magazinë.

23. “Material organik” është produkti organik me origjinë natyrore, i cili mund të identifikohet si lëndë për prodhimin e produkteve plehëruese organo-minerare.

24. “Mikroelemente” janë elementet bor (B), kobalt (Co), bakër (Cu), hekur (Fe), mangan (Mn), molibden (Mo) dhe zink (Zn). Këto elemente janë

thelbësore për rritjen dhe zhvillimin e bimëve, edhe pse në sasi të vogla, nëse krahasohen me elementet ushqyese kryesore dhe dytësore.

25. “Ministër” është ministri përgjegjës për bujqësinë.

26. “Ministri” është ministria përgjegjëse për bujqësinë.

27. “Njësi e tregutit me shumicë” është njësi që shërben për tregtimin e produkteve plehëruese të njësitë e tregutit me pakicë.

28. “Njësi e tregutit me pakicë” është njësi që shërben për tregtimin e produkteve plehëruese të përdoruesi i fundit.

29. “Përfaqësues i autorizuar” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, i cili ka një akt përfaqësimi nga prodhuesi për të vepruar në emër të tij për detyra specifike, për detyrimet e prodhuesit që parashikohen në këtë ligj ose aktet nënligjore në zbatim të tij.

30. “Përmbajtje e deklaruar për produktet plehëruese” është përmbajtja e një elementi ose e formave të tij, e cila tregohet në etiketën ose dokumentin që shoqëron një produkt plehërues.

31. “Përmbajtje e padeklaruar për produktet plehëruese” është përmbajtja e një elementi ose e formave të tij, e cila nuk tregohet në etiketën ose dokumentin që shoqëron një produkt plehërues.

32. “Përmirësues të tokës” janë materialet që duhet të shtohen në tokë, kryesisht për të ruajtur ose përmirësuar karakteristikat fizike ose kimike, ose aktivitetin biologjik të saj, veçmas ose së bashku me njëri-tjetrin.

33. “Plehërues” është produkti, funksioni kryesor i të cilit është të sigurojë elemente ushqyese për bimët.

34. “Produkt plehërues - PP” është lënda, përzierja, mikroorganizmi ose çdo material tjetër që përdoret të bimët ose rizofera e tyre, vetëm ose i përzier me material tjetër, me qëllim furnizimin me elemente ushqyese ose përmirësimin e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve.

35. “Produkt plehërues inorganik” është produkti plehërues, në të cilin elementet ushqyese të deklaruara janë të pranishme në formën e përbërjeve minerale të përfuara nga nxjerrja ose proceset fizike e kimike industriale ose proceset industriale fizike ose kimike. Kalcium cianamidi, ureja dhe produktet e saj të kondensimit e të lidhjes, si dhe produktet plehëruese që përmbajnë



mikroelemente të keluara ose komplekse mund të klasifikohen si produkte plehëruese inorganike.

36. “Produkt plehërues organik” është produkti plehërues që rrjedh nga materialet organike me origjinë shtazore ose bimore, të përbërë nga përbërësit organikë, në të cilët elementet kryesore të fertilitetit janë të lidhura kimikisht në formë organike ose, në çdo rast, formojnë një pjesë integrale të materialit.

37. “Produkt plehërues organo-mineral” është produkti plehërues, i përftuar nga reaksioni ose përzjerja e një ose më shumë produkteve plehëruese organike, ose të një apo më shumë materialeve organike, ose të dyja, me një ose më shumë produkte plehëruese inorganike.

38. “Produkte plehëruese me veprim specifik” janë produkte plehëruese që kontribuojnë në mënyrë specifike në tokë, bimë ose te produktet plehëruese, të cilat nxisin ose rregullojnë përvetësimin e elementeve ushqyese ose korrigjojnë anomali të caktuara fiziologjike.

39. “Produkte plehëruese të veçanta” janë produkte plehëruese që veprojnë si substanca për të nxitur efikasitetin e për të rregulluar përthithjen e elementeve ushqyese.

40. “Produkt plehërues i thjeshtë” është produkti plehërues azotik, fosfatik ose potasik, për të cilin mund të deklarohet vetëm një nga përbërësit kryesorë të elementeve ushqyese.

41. “Produkt plehërues i përbërë” është produkti plehërues që ka një përmbajtje të deklaruar të të paktën dy prej elementeve ushqyese kryesore dhe të siguruara në rrugë kimike ose nga përzjerja apo një kombinim i të dyjave.

42. “Produkt plehërues i përzjer” është produkti plehërues që sigurohet nga përzjerja e thatë e produkteve plehëruese të ndryshme, pa shkaktuar reaksione kimike.

43. “Produkt plehërues kompleks” është produkti plehërues i përbërë, i përftuar nga reaksioni kimik, si solucion apo në gjendje të ngurtë nga granulimi, që ka një përmbajtje të deklaruar të të paktën dy prej elementeve ushqyese kryesore. Në gjendje të ngurtë çdo grimcë përmban të gjitha elementet ushqyese përbërëse të tyre, të deklaruara.

44. “Produkte plehëruese për bujqësinë organike” janë produktet plehëruese, për të cilat lejohet përdorimi sipas metodës së prodhimit organik, sipas legjislacionit të bujqësisë organike.

45. “Produkt plehërues i hapur” është produkti plehërues jo i paketuar (rifuxho).

46. “Produkt plehërues i tjetërsuar” është çdo ndryshim i treguesve të produktit plehërues nga ato të deklaruara në etiketë ose në certifikatën shoqëruese të analizës.

47. “Produkt plehërues i rrjedhur” është produkti plehërues i lëngshëm, i cili ka rrjedhur gjatë ruajtjes ose transportit.

48. “Produkt plehërues me rrezikshmëri” është produkti plehërues i thjeshtë me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti.

49. “Prodhim” është procesi i nxjerrjes së gatshme për përdorim të produkteve plehëruese, duke përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin e tyre.

50. “Prodhues” është çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon një produkt plehërues ose ka një produkt të disenuar dhe e tregon këtë produkt nën emrin dhe/ose markën e tij tregtare.

51. “Regjistër i prodhuesve të produkteve plehëruese” është tërësia e të dhënave zyrtare, ku regjistrohen prodhuesit e produkteve plehëruese në territorin e Republikës së Shqipërisë.

52. “Reklamim për produktin plehërues” është çdo formë informimi, veprimtarie mbështetëse ose nxitëse e destinuar për të rritur informimin për përdorimin e produktit plehërues.

53. “Seri” është një sasi e caktuar e lëndës së parë e materialit ambalazhues ose e produktit përfundimtar, prodhuar gjatë një procesi të vetëm ose e disa proceseve të njëpasnjëshme, e cila siguron homogjenitetin e gjithë sasisë.

54. “SPPP” është struktura përgjegjëse për produktet plehëruese në ministri.

55. “Substrate kultivimi” janë materialet, përveç tokës, ku rriten bimët.

56. “Tolerancë” është shmangia e lejuar e vlerave të matura të përmbajtjes së elementeve ushqyese nga vlera e deklaruar e tyre.

57. “Tregtim i produkteve plehëruese” është veprimtaria e tregtimit me shumicë dhe me pakicë, e cila lidhet me blerjen, magazinimin, shpërndarjen, prezantimin për shitje ose shitjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të produkteve plehëruese.

58. “Vendosje në treg” është bërja e disponueshme për herë të parë e produktit plehërues në treg.



Neni 5

Klasifikimi produkteve plehëruese

1. Produktet plehëruese klasifikohen në grupe si më poshtë:

- a) produktet plehëruese inorganike;
- b) produktet plehëruese organike;
- c) produktet plehëruese organo-minerare;
- ç) produktet plehëruese bazuar në elemente ushqyese dytësore;
- d) produktet plehëruese bazuar në mikroelemente;
- dh) produktet plehëruese me veprim specifik (frenuesit, biostimulantët e bimëve);
- e) produktet plehëruese të veçanta;
- ë) korrektuesit;
- f) substratet e kultivimit (rritjes);
- g) përmirësuesit e tokës;
- gj) materialet organike të destinuara për prodhimin e produkteve plehëruese organo-minerare.

2. Klasifikimi i hollësishëm i produkteve plehëruese të lejuara për regjistrim miratohet me urdhër të ministrit.

KREU II

**PRODHIMI DHE REGJISTRIMI I
PRODUKTEVE PLEHËRUESE**

Neni 6

Prodhimi i produkteve plehëruese

1. Prodhimi i produkteve plehëruese në Republikën e Shqipërisë kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet e lejet, si dhe të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

2. Prodhimi i produkteve plehëruese në vend kryhet nga persona juridikë ose fizikë, pas certifikimit nga një trupë certifikuese, e akredituar në përputhje me standardin SSH ISO/IEC 17065.

3. Prodhimi i produkteve plehëruese me rrezikshmëri përfshihet në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Prodhimi i produkteve plehëruese me rrezikshmëri kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar e të pajisur me lejen përkatëse të mjedisit për këtë veprimtari, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi, si dhe pas

certifikimit nga një trupë certifikuese, e akredituar në përputhje me standardin SSH ISO/IEC 17065.

Neni 7

**Kërkesat që duhet të plotësohen për
regjistrimin e produkteve plehëruese**

1. Të gjitha produktet plehëruese që prodhohen, importohen e tregtohen për t’u përdorur në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit.

2. Një produkt plehërues mund të regjistrohet, nëse përmbush kërkesat, si më poshtë:

- a) produkti plehërues të jetë i miratuar, sipas pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji;
- b) lënda ushqyese garanton siguri, cilësi dhe efektshmëri;
- c) ekzistojnë metodat e analizave dhe të testimeve;
- ç) nuk ndikon negativisht në shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve dhe në mjedis;
- d) përmbush të gjitha kërkesat për ambalazhimin, etiketimin dhe magazinimin, sipas dispozitave të këtij ligji;
- dh) përmbush kufijtë e tolerancës.

Neni 8

**Aplikimi dhe procedura për regjistrimin e
produkteve plehëruese**

1. Aplikimi për regjistrimin e produktit plehërues përmban:

- a) kërkesën e aplikantit për regjistrimin e produktit plehërues në gjuhën shqipe;
- b) të dhënat teknike të produktit plehërues në gjuhën shqipe ose angleze;
- c) etiketën, të përkthyer dhe në gjuhën shqipe;
- ç) dokumentacionin për të dhënat e sigurisë (MSDS). MSDS të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat specifike, përmbajtjen e formatin e përcaktuar nga legjislacioni përkatës në fuqi për kimikatet;
- d) mostrën e produktit plehërues që kërkon të regjistrojë.

2. Aplikimi për regjistrim, sipas shkronjave “a” dhe “ç”, të këtij neni, kryhet në sistemin *online*, ndërsa mostra, sipas shkronjës “d”, të këtij neni, depozitohet te laboratorit i referencës.

3. Pas pranimit, ky dokumentacion dërgohet nga SPPP-ja te laboratorit i referencës, për të kryer



vlerësimin e të dhënave të produktit plehërues, të cilin e pasqyron në sistemin *online* brenda 5 ditëve.

4. Procedura e regjistrimit të produktit plehërues përfundon brenda 20 ditëve nga aplikimi.

5. Përmbajtja e të dhënave teknike të produkteve plehëruese miratohet me urdhër të ministrit.

6. Procedura e hollësishme e regjistrimit të produkteve plehëruese miratohet me rregullore të ministrit.

Neni 9

Komisioni i regjistrimit të produkteve plehëruese

1. Komisioni është organ kolegjal teknik i përhershëm dhe vendimmarrës.

2. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

- a) zëvendësministri, i cili kryeson komisionin;
- b) dy përfaqësues nga SPPP-ja në ministri;
- c) një përfaqësues nga laboratorit i referencës;
- ç) një përfaqësues nga Agjencitë Përgjegjëse për Këshillimin Bujqësor;

d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin;

dh) një përfaqësues nga shoqatat e fermerëve.

Sekretar i komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese është specialisti që mbulon produktet plehëruese pranë SPPP-së në ministri, i caktuar me urdhër të ministrit.

3. Anëtarët e komisionit miratohen me urdhër të ministrit, pas propozimit të bërë nga institucionet përkatëse.

4. Komisioni është organ vendimmarrës dhe funksionon si më poshtë:

a) komisioni mblidhet kur e kërkon kryetari ose 2/3 e anëtarëve të tij;

b) radha e shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin e produkteve plehëruese bëhet sipas datës së pranimit të tyre;

c) komisioni i zhvillon mbledhjet me pjesëmarrjen e shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij dhe, pasi shqyrton mendimet e laboratorit të referencës, merr vendim me 2/3 e anëtarëve të pranishëm;

ç) komisioni, në mbledhjet e tij, shqyrton:

i) etiketën përfundimtare të produktit plehërues, bazuar në etiketën e paraqitur nga aplikanti;

ii) regjistrimin e produkteve plehëruese në procedurë regjistrimi;

iii) reregjistrimin e produkteve plehëruese, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 13, të këtij ligji;

iv) çregjistrimin e produkteve plehëruese, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të këtij ligji;

v) modifikimin e dokumentit të regjistrimit të produktit plehërues, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

d) në përfundim të mbledhjes hartohet procesverbali përmbledhës për vendimet e marra. Procesverbali mbahet në dy kopje, nga të cilat, njëren e mban SPPP-ja dhe tjetra depozitohet në arkivin e ministrisë bashkë me një kopje të dokumenteve të regjistrimit (certifikatë dhe etiketë). Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje;

dh) dokumentet e regjistrimit (certifikata dhe etiketa) të produkteve plehëruese të miratuara përgatiten nga sekretari dhe firmosen nga kryetari i komisionit.

5. Vendimi për refuzimin e regjistrimit mund të ankimohej pranë ministrit.

6. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 10

Lista e produkteve plehëruese dhe lista e prodhuesve të produkteve plehëruese

1. SPPP-ja përgatit listën e produkteve plehëruese të regjistruara dhe listën e prodhuesve të produkteve plehëruese në vend dhe i publikon në faqen zyrtare të ministrisë sa herë që pësojnë ndryshime.

2. Lista e produkteve plehëruese të regjistruara përmban këto të dhëna:

a) emrin tregtar;

b) përmbajtjen e çdo përbërësi të produktit plehërues;

c) emrin e aplikantit;

ç) prodhuesin (emri, adresa e fabrikimit);

d) grupin;

dh) numrin dhe datën e regjistrimit;

e) importuesin (emri dhe adresa).

3. Lista e prodhuesve të produkteve plehëruese në vend përmban këto të dhëna:

a) prodhuesin (emrin, adresën e selisë ose të fabrikimit të produkteve plehëruese);

b) emrin/emrat tregtar/ë të produkteve plehëruese, që prodhon/prodhojnë;



- c) grupin;
- ç) numrin dhe datën e regjistrimit;
- d) emrin/emrat e lëndëve të para, që përdor për prodhimin e produkteve plehëruese.

Neni 11

Tarifat administrative për regjistrimin e produkteve plehëruese

1. Tarifat administrative për regjistrimin e produkteve plehëruese përballohen nga aplikantët dhe derdhen në buxhetin e shtetit.
2. Tarifat administrative përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 12

Dokumenti i regjistrimit të produktit plehërues

1. Dokumenti i regjistrimit të produktit plehërues përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën. Certifikata e regjistrimit lëshohet nga kryetari i komisionit, jo më vonë se 5 ditë nga data e mbledhjes së komisionit dhe shoqërohet me etiketë.

Dokumenti i regjistrimit mbahet në tri kopje origjinale, nga të cilat, njëra mbahet në arkivin e ministrisë, njëra në SPPP, ndërsa kopja tjetër i jepet aplikantit.

2. Në certifikatën e regjistrimit, e cila plotësohet në gjuhën shqipe, jepen të dhënat si më poshtë:

- a) emri tregtar;
- b) numri dhe data e regjistrimit;
- c) emri i aplikantit dhe adresa e tij;
- ç) emri i prodhuesit dhe adresa e tij;
- d) emri i importuesit në Shqipëri dhe adresa e tij;
- dh) grupi;
- e) pamja e jashtme e tij;
- ë) përmbajtja;
- f) afati i vlefshmërisë;
- g) mënyra e përdorimit (me shënimin: Shih etiketën bashkëlidhur!).

3. Në etiketën e produktit plehërues jepen të dhënat si më poshtë:

- a) emri tregtar;
- b) numri dhe data e regjistrimit;
- c) emri i aplikantit dhe adresa e tij;
- ç) emri i prodhuesit dhe adresa e tij;

- d) emri i importuesit në Shqipëri dhe adresa e tij;

dh) emri i pakuesit, nëse kryhet paketimi në Shqipëri dhe adresa e tij;

- e) emri i grupit, i cili shkruhet me shkronja të mëdha;

ë) pamja e jashtme e tij;

f) përmbajtja e përbërësve të produktit plehërues, përfshirë edhe përmbajtjen e elementeve të përshkruara me fjalë e simbole kimike dhe në lidhje me ushqyesit e format e tretshme;

g) numri i serisë;

gj) mënyra e përdorimit;

h) sasia neto e produktit plehërues, që ndodhet në ambalazhin parësor;

i) afati i ruajtjes;

j) kushtet e ruajtjes;

k) udhëzimet për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, sigurinë e mbrojtjen e mjedisit.

Përmbajtja e etiketës duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në përputhje me rregullat e parashikuara në pikën 4, të nenit 17, të këtij ligji.

Neni 13

Riregjistrimi, çregjistrimi dhe modifikimi i dokumenteve të regjistrimit të produkteve plehëruese të regjistruara

1. Riregjistrimi i produktit plehërues bëhet direkt nga komisioni, kur ky kërkohet nga aplikanti, 30 ditë para përfundimit të afatit të regjistrimit.

2. Çregjistrimi i produktit plehërues kryhet nga komisioni në rastet kur:

- a) produkti plehërues përmban lëndë ushqyese, të cilat janë të hequra me urdhër të ministrit;
- b) aplikanti e kërkon me shkrim një gjë të tillë;
- c) nuk vazhdon të plotësojë kërkesat, sipas nenit 7 të këtij ligji.

Në rastet e çregjistrimit njoftohet aplikanti.

Pas çregjistrimit, nëse produkti plehërues është ende në treg, duhet të përdoret brenda afateve të skadencës së tij, për rastet e cituara në shkronjën “b”, të kësaj pike, dhe të tërhiqet nga tregu, nga importuesi ose nga prodhuesi për rastet e cituara në shkronjat “a” dhe “c” të kësaj pike. Monitorimi i tërheqjes nga tregu kryhet nga institucioni përgjegjës.

3. Modifikimi i dokumentit të regjistrimit të produktit plehërues kryhet nga komisioni kur ka ndryshim të:



- a) emrit tregtar;
- b) mbajtësit të dokumentit të regjistrimit (aplikanti);
- c) prodhuesit;
- ç) prodhimit (shtim, transferim në një stabiliment tjetër prodhues);
- d) mënyrave të përdorimit dhe të sasive të përdorura;
- dh) periudhës dhe të kushteve të ruajtjes;
- e) zgjerimit të fushës së përdorimit.

Në të gjitha rastet e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, aplikanti duhet të paraqesë kërkesë në gjuhën shqipe, shoqëruar me dokumentacionin provues.

KREU III TREGTIMI, TRANSPORTI, RUAJTJA, ETIKETIMI DHE PËRDORIMI I PRODUKTEVE PLEHËRUESE

Neni 14

Tregtimi i produkteve plehëruese

1. Lejohet vetëm importimi dhe tregtimi i produkteve plehëruese të regjistruara.
2. Tregtimi me shumicë dhe me pakicë i produkteve plehëruese me rrezikshmëri përfshihet në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Në njësitë e tregtimit me pakicë të produkteve plehëruese ndalohet:
 - a) mbajtja dhe tregtimi i produkteve plehëruese, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
 - b) asgjësimi i ambalazheve dhe i produkteve plehëruese të skaduar apo të dëmtuara;
 - c) mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz e kafshë;
 - ç) riambalazhimi i produkteve plehëruese, pasi janë vendosur në treg.
3. Institucioni përgjegjës në pikat e kalimit kufitar (PIK) ka për detyrë:
 - a) të kontrollojë e të verifikojë produktet plehëruese që hyjnë për t’u tregtuar dhe përdorur në Republikën e Shqipërisë e t’i evidentojë ato në një regjistër të veçantë;
 - b) të ndalojë hyrjen në Republikën e Shqipërisë të produkteve plehëruese të paregjistruara.
4. Produktet plehëruese, të cilave u skadon afati i përdorimit, të klasifikohen si mbetje dhe të

etiketohen sipas kodeve të përcaktuara në vendimin nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar.

5. Grumbullimi, transportimi, trajtimi dhe asgjësimi i produkteve plehëruese të klasifikuara mbetje të trajtohen sipas detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.

Neni 15

Transporti, ruajtja dhe magazinimi i produkteve plehëruese

1. Transporti i produkteve plehëruese bëhet me mjete të sigurta e të përshtatshme, të mbuluara tërësisht, si masë mbrojtjeje, në çdo rast, nga kontakti me lagështirën, si dhe mënjanon rrjedhjet gjatë udhëtimit.

2. Të gjitha produktet plehëruese, pas prodhimit apo sjelljes nga importi, ruhen në magazinat e tregtimit me shumicë, si dhe në mjediset e tregtimit me pakicë.

3. Kushtet në magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë duhet të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të produkteve plehëruese, sipas kërkesave të përcaktuara në etiketë, si dhe përmbushjen e kërkesave në fuqi për mbrojtjen e mjedisit e kimikatet.

4. Magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë të produkteve plehëruese duhet të jenë të pajisura me:

- a) mjetet e nevojshme për thithjen e dezaktivizimin e rrjedhjeve të produkteve plehëruese të rrjedhura;
- b) këndin e ndihmës së shpejtë dhe mjetet mbrojtëse individuale;
- c) pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;
- ç) mjediset higjieno-sanitare me ujë të rrjedhshëm;
- d) sistemet e duhura të ajrimit.

5. Produktet plehëruese, gjatë magazinimit, duhet:

- a) të jenë të ndarë nga njëri-tjetri;
- b) të jenë të etiketuara në mënyrë të qartë;
- c) të mos jenë të përziera me substanca të tjera;
- ç) të jenë në ambalazhe parësore të padëmtuara.



Neni 16

Ambalazhimi dhe etiketimi i produkteve plehëruese

1. Produktet plehëruese mund të vendosen në treg vetëm të ambalazuara.
2. Ambalazhi duhet të ruajë karakteristikat fizike dhe kimike të produkteve plehëruese.
3. Ambalazhi parësor, që është në kontakt direkt me produktin plehëruës, duhet të jetë i mbyllur në mënyrë të tillë që, në rast se hapet, të jetë e pamundur të rimbyllet.
4. Etiketa të jetë e ngjitur në mënyrë të pashqitshme në ambalazhin parësor të produktit plehëruës, si dhe përmbajtja e saj të jetë qartësisht e lexueshme dhe jo e shuajtshme.
5. Ambalazhimi dhe etiketimi i produkteve plehëruese me rrezikshmëri përfshihet në licencën “Prodhimi”, me kodin II.5.B.1.

Neni 17

Përdorimi i produkteve plehëruese

1. Lejohet vetëm përdorimi i produkteve plehëruese të regjistruara.
2. Produktet plehëruese duhet të përdoren nga përdoruesi i fundit, duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet që jepen në etiketë.
3. Përdorimi i produkteve plehëruese duhet të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të përdoruesve, të konsumatorëve, të kafshëve dhe të mjedisit.
4. Rregullat e hollësishme për prodhimin, tregtimin, ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe aktet nënligjore për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve.

KREU IV

KUFIJTË E TOLERANCËS. PRODUKTET PLEHËRUESE TË THJESHTA ME BAZË NITRAT AMONI, ME PËRMBAJTJE TË LARTË AZOTI

Neni 18

Kufijtë e tolerancës

1. Përmbajtja e deklaruar në produktet plehëruese duhet të jetë në përputhje me kufijtë e tolerancës.
2. Në përcaktimin e kufijve të tolerancës merren parasysh variacionet në aspektin e prodhimit, marrjes së mostrave për analizë, pasiguritë e matjeve, si dhe metodat analitike të përdorura.
3. Prodhuesi nuk mund të përfitojë sistematikisht nga kufijtë e tolerancës.
4. Kufijtë e tolerancës miratohen me urdher të ministrit.

Neni 19

Produktet plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti

1. Produktet plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, mund të përmbajnë substanca inorganike ose inerte. Substancat që janë përdorur në prodhimin e këtij produkti plehëruës nuk duhet të rrisin ndjeshmërinë e tij ndaj nxehtësisë e ndaj shpërthimit.
2. Prodhuesi duhet të sigurojë që produktet plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, duhet të plotësojnë kërkesat e këtij ligji.
3. Kontrolli, analizat dhe testimet zyrtare të produkteve plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, të referuara në këtë nen, duhet të jenë në përputhje të plotë me standardet e harmonizuara apo të miratuara nga institucioni përgjegjës për standardizimin.
4. Për të siguruar gjurmueshmërinë e produkteve plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, të vendosura në treg, prodhuesi mban një regjistër të veçantë vetëm për këtë lloj produkti plehëruës, ku përcaktohen emri, adresa dhe vendndodhja e prodhuesit, si dhe e përdoruesve të tij. Ky regjistër duhet të jetë i disponueshëm për kontrollet që



kryhen për të gjithë periudhën e vendosjes në treg të këtij produkti plehërues.

5. Prodhuesi duhet të sigurojë që produkti plehërues me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, që vendoset në treg, të ketë kaluar testin e rezistencës ndaj shpërthimit. Ky test duhet të jetë bërë në një laborator testues të akredituar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kalimi i testit të shpërthyeshmërisë është kusht i domosdoshëm për të gjitha produktet plehëruese që vendosen në treg.

KREU V ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE

Neni 20 **Organizimi**

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij janë si më poshtë:

- a) struktura përgjegjëse për produktet plehëruese (SPPP) në ministri;
- b) institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese;
- c) komisioni i regjistrimit të produkteve plehëruese (KRPP) në ministri;
- ç) laborator i referencës dhe laboratorët e miratuar.

Neni 21 **Struktura përgjegjëse për produktet plehëruese**

SPPP-ja ka këto detyra:

- a) zhvillon proceduarat që lidhen me regjistrimin e produkteve plehëruese, në përputhje me kërkesat e këtij ligji;
- b) ndjek e monitoron aktivitetin e produkteve plehëruese në nivel qendror dhe rajonal, në zbatim të këtij ligji.

Neni 22 **Institucionet përgjegjëse**

Institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve

plehëruese përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23 **Laboratori i referencës dhe laboratorët e miratuar**

1. Laboratori i referencës miratohet me urdhër të ministrit dhe ka për detyrë:

- a) vlerësimin e të dhënave teknike të produkteve plehëruese gjatë procedurës së regjistrimit të tyre;
- b) kryerjen e analizave laboratorike zyrtare të produkteve plehëruese;
- c) testimin e produktit plehërues, sipas standardeve përkatëse dhe vlerësimin, nëse është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;
- ç) kryerjen e analizave të mostrave të produkteve plehëruese, që merren për efekt verifikimi dhe vlerësimin e treguesve cilësorë të tyre;
- d) hartimin e raportit teknik, sipas pikës 3, të nenit 8, të këtij ligji;
- dh) vlerësimin e laboratorëve të miratuar për:
 - i) rezultatet e analizave të kryera;
 - ii) bashkërendimin e punës dhe dhënien e mbështetjes, përfshirë trajnimet e shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe mënyrat e analizave që ato kryejnë;
 - iii) organizimin e testeve paralele të mostrave të standardizuara.

2. Laboratorët miratohen me urdhër të ministrit dhe kanë për detyrë kryerjen e analizave laboratorike të produkteve plehëruese të hedhura në treg.

3. Laboratori i referencës dhe laboratorët e miratuar miratohen vetëm pasi të jenë akredituar. Lista e analizave të miratuara duhet të jetë e përfshirë në listën e analizave për të cilat ato janë akredituar dhe miratohet me urdhër të ministrit.

4. Kriteret që duhet të plotësojë laborator i referencës dhe laboratorët e miratuar, si dhe procedura për miratimin e tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

5. Metodot e analizave të produkteve plehëruese të jenë në përputhje me standardet e harmonizuara apo të miratuara nga institucioni përgjegjës për standardizimin.

6. Tarifat e shërbimeve e të analizave, që kryhen nga laborator i referencës dhe laboratorët e miratuar, përcaktohen me vendim të Këshillit të



Ministrave. Këto të ardhura derdhen në buxhetin e shtetit.

KREU VI
ANALIZIMI, GJURMUESHMËRIA DHE
REKLAMIMI I PRODUKTEVE
PLEHËRUESE

Neni 24
Analizimi

1. Analizat laboratorike të mostrave të produkteve plehëruese bëhen në laboratorin e referencës dhe në laboratorët e miratuar, sipas metodave të përcaktuara në pikën 5, të nenit 23, të këtij ligji.

2. Kontrolli për cilësinë e produkteve plehëruese të vendosura në treg kryhet në bazë të planit vjetor të marrjes dhe të analizimit të mostrave, miratuar me urdhër të ministrit.

3. Rregullat për marrjen e mostrave, analizat e procedurat, dhënia e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimi i analizave të produkteve plehëruese janë në varësi të metodave apo të standardeve me të cilat kryhet testimi.

Neni 25
Gjurmueshmëria

1. Gjurmueshmëria përcaktohet në të gjitha nivelet e prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese.

2. Prodhuesit dhe tregtuesit e produkteve plehëruese krijojnë sisteme për mbajtjen e të dhënave, të cilat mundësojnë identifikimin në çdo çast të produktit plehërues, si dhe të çdo personi fizik apo juridik që i ka furnizuar apo është furnizuar me produkte plehëruese. Këto të dhëna ruhen për tre vjet dhe vihen në dispozicion të institucionit përgjegjës.

3. Për qëllimet e gjurmueshmërisë së produkteve plehëruese nga SPPP-ja në ministri mbahet “Regjistri i produkteve plehëruese”, i cili përmban një seksion të veçantë për ata që lejohen në bujqësinë organike, si dhe “Regjistri i prodhuesve të produkteve plehëruese”.

Neni 26
Informimi dhe reklamimi i produkteve
plehëruese

1. Ministria publikon në faqen e saj zyrtare listën e produkteve plehëruese që lejohet të qarkullojnë në vendin tonë, si dhe median e shkruar ose elektronike, prodhuesit, importuesit, tregtuesit për veprimtaritë e organizuara lidhur me sigurinë, cilësinë, efektshmërinë, përdorimin dhe parandalimin e rreziqeve nga tregtimi dhe përdorimi i produkteve plehëruese.

2. Reklamimi në median e shkruar ose elektronike bëhet nga aplikanti dhe lejohet vetëm për produktet plehëruese të regjistruara dhe në përputhje me dokumentin e regjistrimit.

3. Ndalohet reklamimi në median e shkruar ose elektronike i produkteve plehëruese me rrezikshmëri.

KREU VII
VEPRIMTARI TË NDALUARA DHE
MUNGESA NË PESHË.
ASGJËSIMI I PRODUKTEVE
PLEHËRUESE

Neni 27
Veprimtari të ndaluara

Ndalohet prodhimi, importi, vendosja në treg dhe përdorimi:

- a) i produkteve plehëruese të paregjistruara;
- b) i produkteve plehëruese me përmbajtje substancash të dëmshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë ose shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve ose një rrezik për mjedisin;
- c) i produkteve plehëruese të falsifikuara;
- ç) i produkteve plehëruese të tjetërsuara;
- d) i produkteve plehëruese me përmbajtje të padeklaruar;
- dh) i produkteve plehëruese të skaduara.

Neni 28
Pesha neto e produkteve plehëruese

1. Pesha neto e produkteve plehëruese të ambalazhuara për tregtim duhet të jetë e njëjtë me atë të shkruar në etiketë. Kufijtë e tolerancës miratohen me urdhër të ministrit.



2. Prodhuesi nuk mund të përfitojë sistematikisht nga kufijtë e tolerancës.

Neni 29

Asgjësimi i produkteve plehëruese dhe i ambalazheve të tyre

1. Produktet plehëruese, ambalazhet dhe materialet e tjera, që duhet të asgjësohen ose të trajtohen, janë:

a) produktet plehëruese, të cituara në shkronjat “b”, “c”, “ç” e “d”, të nenit 27, të këtij ligji;

b) produktet plehëruese që kanë rrjedhur gjatë ruajtjes e transportit dhe materialet e përdorura për thithjen e dezaktivizimin e tyre;

c) ambalazhet, si: fuçi, bidonë, shishe, kuti, qese dhe objekte të tjera të ngjashme, të boshatisura;

ç) sendet e ndotura gjatë punës, si: pajisje mbrojtëse, enë të ndryshme, mjete pastrimi, objekte të tjera të ngjashme, të cilat nuk mund të përdoren më.

2. Importuesit dhe prodhuesit e produkteve plehëruese, për produktet plehëruese të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, janë të detyruar t’i largojnë ato nga territori i Republikës së Shqipërisë ose të bëjnë djegien (incinerimin) e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndotjen e mjedisit.

3. Asgjësimi i produkteve plehëruese me djegie brenda territorit të Republikës së Shqipërisë bëhet nga subjekte të specializuara për këtë qëllim, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për lejet e licencat.

4. Rastet e përmendura në shkronjat “b”, “c” e “ç”, të pikës 1, të këtij neni, trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

KREU VIII

KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Neni 30

Kundërvajtje administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me:

a) gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në rastet kur vepron në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25, dhe të nenit 28, të këtij ligji;

b) gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë, në rastet kur vepron në kundërshtim me pikën 3, të nenit 14, pikat 1, 4 e 5, të nenit 15, nenin 16, si dhe pikat 4 e 5, të nenit 19, të këtij ligji;

c) gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë, në rastet kur vepron në kundërshtim me nenin 6, pikat 1 e 2, të nenit 14, pikën 1, të nenit 18, si dhe pikat 1, 2 e 6, të nenit 19, të këtij ligji;

ç) gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë, në rastet kur vepron në kundërshtim me nenin 27, si dhe në rast përsëritjeje të kundërvajtjeve administrative të parashikuara në pikat 1 e 2, të nenit 14, pikën 1, të nenit 6, si dhe pikat 1, 2 e 6, të nenit 19, të këtij ligji.

2. Për shkeljet e dispozitave të këtij ligji, të cilat, sipas pikës 1, të këtij neni, përbëjnë kundërvajtje administrative, përveç masës së vënies së gjobës, e cila është dënim kryesor, vendosen edhe dënime plotësuese, si: masa e kthimit të ngarkesave, në rastin e shkeljeve të dispozitave të nenit 27, të këtij ligji; heqja e së drejtës së tregtimit me shumicë ose pakicë dhe heqja e licencës aty ku parashikohet licencimi, në rastin e shkeljeve të dispozitave të shkronjave “b”, “c” dhe “d”, të nenit 27, të këtij ligji; asgjësimi, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 29, të këtij ligji, si dhe masa urgjente, si: masa e bllokimit, në rastin e shkeljeve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “e”, të nenit 27, të këtij ligji, dhe masa e bllokimit, në rast përsëritjeje të shkeljeve të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji.

3. Të gjitha të ardhurat nga gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 31

Procedurat e kundërvajtjes administrative

1. Institucioni përgjegjës jep masat administrative, siç është përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji.

2. Procedura e konstatimit dhe e vendosjes të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në përputhje me legjislacionin në fuqi.



KREU IX
DISPOZITA TË FUNDIT DHE
KALIMTARE

Neni 32
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë, brenda një viti pas hyrjes në fuqi, aktet nënligjore, në zbatim të pikës 4, të nenit 17; të nenit 22; dhe të pikës 6, të nenit 23, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë, brenda një viti pas hyrjes në fuqi, aktet nënligjore, në zbatim të pikës 2, të nenit 5; të pikave 5 e 6, të nenit 8; të pikave 2, 3 e 6, të nenit 9; të pikës 3, të nenit 18; të pikave 1, 2, 3 e 4, të nenit 23; dhe të nenit 28, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për financat të nxjerrin, brenda një viti pas hyrjes në fuqi, aktet nënligjore, në zbatim të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji.

Neni 33
Shfuqizimet

1. Ligji nr. 10 390, datë 3.3.2011, “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”, shfuqizohet.

2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktuara në nenin 32, të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011, “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”, për aq sa përputhen me ligjin në fuqi.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.2.2020

Shpallur me dekretin nr. 11447, datë 6.3.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11447, datë 6.3.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 17/2020, “Për produktet plehëruese”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 22/2020

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.
71/2016 “PËR KONTROLLIN KUFITAR”¹**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” bëhen këto shtesa:

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Direktivën 2004/82 KE të Këshillit të Europian të datës 29 prill 2004, mbi detyrimin e transmetimit të të dhënave të pasagjerit. Numri CELEX 32004L0082, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 261, datë 6.8.2004, faqe 24–27;

- Direktivën BE 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit, datë 27.4.2016, mbi përdorimin e të dhënave të regjistrimit të emrit të pasagjerit (PNR) me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale veprave me qëllime terroriste dhe krimeve të rënda. Numri CELEX 32016L0681, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 119, datë 4.5.2016, faqe 132–149.



Neni 1

Në nenin 1, pas fjalëve “rregullat për” shtohen fjalët “transmetimin e të dhënave të pasagjerit dhe”.

Neni 2

Në nenin 2, pas pikës 8 shtohen pikat 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 22 me këtë përmbajtje:

“9. “Regjistri i rezervimit të pasagjerit” është tërësia e të dhënave të nevojshme për të mundësuar rezervimin dhe për të kryer kontrollat për çdo udhëtim të rezervuar nga/ose në emër të një personi, të cilat ruhen në sistemin e rezervimit të linjave ajrore, sistemet e kontrollit të nisjes që përdoren për të kontrolluar/administruar/menaxhuar pasagjerët ose sisteme ekuivalente që mundësojnë të njëjtat funksione.

10. “Të dhënat personale”, “regjistrimi” dhe “përpunim i të dhënave personale” kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 3 “Përkufizime” të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

11. “Informacioni paraprak për pasagjerin (API)” është pjesë e të dhënave të regjistrimit të rezervimit të pasagjerit dhe përfshin llojin, numrin, vendin e lëshimit dhe datën e skadimit të çdo dokumenti udhëtimi, shtetësinë, mbiemrin, emrin/emrat e tjerë, gjininë, datën e lindjes, linjën e fluturimit, numrin e fluturimit, datën e nisjes, datën e mbërritjes, aeroportin e nisjes, aeroportin e mbërritjes, kohën e nisjes dhe kohën e mbërritjes, si dhe numrin e përgjithshëm të pasagjerëve që transportohen.

12. “Autoritete kompetente” janë institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, të cilat, sipas legjislacionit të posaçëm, kanë objekt të veprimtarisë së tyre parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave me qëllime terroriste apo krimeve të përcaktuara në nenin 19/3 të këtij ligji.

13. “Transportues ajror” nënkupton çdo subjekt të licencuar për kryerjen e transportit ajror të pasagjerëve.

14. “Sistem rezervimi” nënkupton sistemin e brendshëm të transportuesve ajrorë, të cilët, gjatë veprimtarisë së tyre, grumbullojnë të dhënat për rezervimin e fluturimeve.

15. “Pasagjer” është çdo person, përfshirë edhe personat që udhëtojnë transit në Republikën e

Shqipërisë, me përjashtim të anëtarëve të ekuipazhit dhe që rezultojnë në listën e pasagjerëve.

16. “Anonimizim i të dhënave” nënkupton bërjen të padukshme për një përdorues të atyre të dhënave, të cilat mund të shërbejnë për të identifikuar drejtpërdrejt subjektin e të dhënave.

17. “Njësia e informacionit të pasagjerit” është struktura pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila përpunon të dhënat e pasagjerit.

18. “Baza e të dhënave të pasagjerit” është baza e të dhënave që përmban të gjitha të dhënat e regjistrimit të rezervimit të pasagjerit dhe administrohet nga Njësia e Informacionit të Pasagjerit.

19. “Subjekt i të dhënave” është personi fizik, të cilit i përpunohen të dhënat që transmetohen nga transportuesi ajror, sipas këtij ligji.

20. “Kod i përbashkët” është transportimi i pasagjerëve nga një apo më shumë transportues ajrorë, për llogari të transportuesve të tjerë ajrorë.

21. “Metoda e transmetimit të sigurt” është procesi i transmetimit të të dhënave të pasagjerit, i cili mundëson përcaktimin e saktë të periudhës së regjistrimit fillestar të të dhënave, si dhe mbrojtjen e përshtatshme të të dhënave gjatë transmetimit.

22. “Personi i ngarkuar për mbrojtjen e dhënave (DPO)” është personi përgjegjës për monitorimin e përpunimit të të dhënave të pasagjerit dhe zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

Neni 3

Pas kreut II shtohet kreu II/1 me këtë përmbajtje:

“KREU II/1

TË DHËNAT E PASAGJERIT

Neni 19/1

Njësia e Informacionit të Pasagjerit dhe baza e të dhënave të pasagjerit

1. Njësia e Informacionit të Pasagjerit, në vijim “NIP”, kryen grumbullimin, përpunimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të dhënave të pasagjerit.

2. NIP-i administron bazën e të dhënave të pasagjerit dhe regjistron, të paktën, veprimet e përpunimit të të dhënave, që kanë të bëjnë me:

a) grumbullimin;



- b) ndryshimin;
 - c) konsultimin;
 - ç) shpërndarjen/shkëmbimin kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - d) fshirjen/shkatërrimin;
 - dh) anonimizimin dhe zbulimin e të dhënave.
3. Regjistrimet e konsultimit dhe të transmetimit të të dhënave duhet të dokumentojnë arsyen e kryerjes së këtyre veprimeve, datën dhe identitetin e personit që është njohur ose ka shpërndarë të dhënat e pasagjerit, si dhe identitetin e marrësve të të dhënave.
4. Regjistrimet e të dhënave të pikës 2, të këtij neni, vendosen në dispozicion të personit të ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave dhe Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës, për të mundësuar monitorimin e të gjithë veprimtarisë së përpunimit, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Rregullat për organizimin, funksionimin e NIP-it, si dhe për përdorimin e aksesin në bazën e të dhënave të pasagjerit përcaktohen në rregulloren për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.

Neni 19/2

Transmetimi i të dhënave të pasagjerit

1. Çdo transportues ajror duhet të transmetojë pranë NIP-it, me kërkesën e autoriteteve përgjegjëse për kontrollin kufitar, deri në fund të *check in*, nëpërmjet metodës së transmetimit të sigurt, të dhënat e regjistrit të rezervimit të pasagjerit, të mbledhura gjatë veprimtarisë së tyre, përfshirë pasagjerët me destinacion përfundimtar Republikën e Shqipërisë, si dhe ata që udhëtojnë nga apo nëpërmjet aeroporteve të Republikës së Shqipërisë.
2. Regjistri i rezervimit të pasagjerit përfshin të dhënat si më poshtë:
- a) kodin e konfirmimit të rezervimit të pasagjerit;
 - b) datën e rezervimit dhe të lëshimit të biletës;
 - c) emrin/emrat dhe mbiemrin e pasagjerit;
 - ç) datën/datat e planifikuar/a të udhëtimit;
 - d) adresën dhe të dhënat e kontaktit, përfshirë numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike;
 - dh) informacion për biletën, përfshirë numrin, datën e lëshimit, mënyrën e pagesës, si dhe adresën e përdorur për faturimin e saj;
 - e) të gjithë informacionin në lidhje me bagazhin;

ë) informacionin paraprak të pasagjerit (API) të mbledhur, përfshirë llojin, numrin, vendin e lëshimit dhe datën e skadimit të çdo dokumenti udhëtimi, shtetësinë, emrin dhe mbiemrin, emrin/emrat e tjerë, gjininë, datën e lindjes, linjën ajrore, numrin e fluturimit, datën e nisjes, datën e mbërritjes, aeroportin e nisjes, aeroportin e mbërritjes, kohën e nisjes dhe kohën e mbërritjes, si dhe numrin në total të pasagjerëve që transportohen;

- f) itinerarin e plotë të udhëtimit;
 - g) informacion për pasagjerë të shpeshtë;
 - gj) agjencinë dhe agjentin e udhëtimit;
 - h) statusin e udhëtimit të pasagjerit, përfshirë konfirmimin, statusin e *check in*-it, mosparaqitjen për *check in*, biletë pa rezervim;
 - i) informacion mbi kode të ndryshme apo të veçuara të konfirmimit të rezervimit;
 - j) informacione për të mitur të pashoqëruar nën 18 vjeç, si: emri dhe gjinia e të miturit, moshja, gjuha/gjuhët që flet, emri dhe detajet e kontaktit të kujdestarit në nisje dhe lidhja/marrëdhënia e tij me të miturin, emrin dhe detajet e kontaktit të kujdestarit në mbërritje dhe lidhja/marrëdhënia e tij me të miturin;
 - k) numrin e ndenjës dhe informacione të tjera të lidhura me ndenjësën;
 - l) informacion për kodin e përbashkët të fluturimit;
 - ll) numrin total të pasagjerëve, si dhe të dhënat identifikuese të udhëtarëve të tjerë që rezultojnë në regjistrin e rezervimit të pasagjerit;
 - m) të gjitha ndryshimet historike në të dhënat e pasagjerëve të listuara nga shkronjat “a” deri në “l”.
3. Të dhënat e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, transmetohen për të gjitha fluturimet e planifikuara, përfshirë udhëtimet me çarter dhe taksë, për qëllime joushtarake, që:
- a) nisen nga Republika e Shqipërisë me destinacion vende të tjera;
 - b) nisen nga vende të tjera me destinacion Republikën e Shqipërisë ose transit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë.
4. Kur fluturimi kryhet me kod të përbashkët, ndërmjet një ose më shumë transportuesve ajrorë, transportuesi ajror që kryen fluturimin është i detyruar të transmetojë pranë NIP-it të dhënat, sipas pikës 2, të këtij neni, për të gjithë pasagjerët në fluturim.



5. Transportuesit ajrorë duhet të informojnë pasagjerët për qëllimin e grumbullimit dhe të përpunimit të të dhënave të rezervimit të pasagjerit, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Transmetimi i të dhënave të pasagjerit nga transportuesit ajrorë kryhet me mjete elektronike, sipas procedurave e formateve të përcaktuara në rregulloren për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit. Në rast të një problemi teknik, të dhënat do të transmetohen sipas mënyrës së përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që siguron nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes të të dhënave.

7. Në çdo rast, transportuesit ajrorë nuk duhet të mbledhin, të përpunojnë dhe të transmetojnë të dhëna sensitive, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në rast se transportuesit ajrorë transmetojnë të dhëna të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, NIP-i kryen menjëherë fshirjen e tyre në mënyrë të pakthyeshme.

8. Rregullorja për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19/3

Përpunimi i të dhënave të pasagjerit

1. Të dhënat e regjistrit të rezervimit të pasagjerit, sipas pikës 2, të nenit 19/2, të këtij ligji, grumbullohen dhe përpunohen nga NIP-i, si dhe shpërndahen apo shkëmbehen me autoritetet kompetente, me qëllimin e vetëm parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjen penale të veprave të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83, 86, 87, 88, 88/a, 89/a, 101, 102, 102/a, 103, 104, 109, 109/a, 109/b, 109/c, 110/2, 110/a, 110/b, 110/c, 111, 114, 117/2 dhe 3, 128/b/2 dhe 3, 138/a, 139, 140, 141, 141/a, 143, 143/a, 143/a/1, 143/a/2, 143/a/3, 143/a/4, 143/b, 144, 145, 146, 149/a, 164, 164/a, 164/b, 186, 186/a, 187, 188, 189, 190, 192/b, 201, 202, 206/a, 206/b, 244, 244/a, 245, 245/1, 259, 259/a, 260, 278/a, 282/a, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 287, 288/a/2, 293/a, 293/b, 293/c, 295/a/2, 298, 319, 319/a, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/e, 333, 333/a, të veprave penale me qëllime

terroriste, që parashikohen nga kreu VII, i Kodit Penal, si dhe krimet që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

2. Informacioni paraprak për pasagjerin, sipas shkronjës “ë”, të pikës 2, të nenit 19/2, shpërndahet nga NIP-i pranë autoriteteve përgjegjëse për kontrollin kufitar, me qëllim parandalimin e migracionit të paligjshëm dhe përmirësimin e kontrollit kufitar.

3. Autoritetet kompetente, bazuar në parimin e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mbrojtjes së të dhënave personale, nuk duhet të marrin asnjë vendim që ka efekte të pafavorshme mbi subjektin e të dhënave, vetëm mbi bazën e përpunimit të automatizuar të të dhënave të pasagjerit.

Neni 19/4

Afati për transmetimin e të dhënave

1. Transportuesit ajrorë transmetojnë pranë NIP-it të dhënat e pasagjerit:

a) 48 deri në 24 orë përpara kohës së planifikuar të nisjes së fluturimit; dhe

b) menjëherë pasi kanë përfunduar procedurat e imbakimit dhe është e pamundur që pasagjerët të hyjnë ose të dalin, si dhe avioni është në përgatitje për nisje, duke përditësuar kështu të dhënat e transmetuara sipas shkronjës “a” të kësaj pike.

2. Në raste të veçanta, kur vlerësohet se rreziku për kryerjen e veprave penale, sipas pikës 1, të nenit 19/3, të këtij ligji, është real dhe i çastit, me kërkesën e NIP-it, të dhënat e pasagjerit transmetohen menjëherë.

Neni 19/5

Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente, të cilat kanë të drejtë të kërkojnë, të konsultojnë, të marrin të dhënat e pasagjerit ose rezultatet e përpunimit të tyre, me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin e ndjekjen penale të veprave penale sipas nenit 19/3, të këtij ligji, janë:

- a) strukturat operationale të Policisë së Shtetit;
- b) Shërbimi Informativ i Shtetit;
- c) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- ç) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.



2. Autoritet kompetente, sipas pikës 1, të këtij neni, caktojnë përfaqësues të tyre pranë NIP-it.

3. Autoritetet kompetente përpunojnë të dhënat e pasagjerit, me qëllim përmirësimin e kontrollit kufitar, parandalimin e migracionit të paligjshëm, si dhe parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale, të krimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 19/3, të këtij ligji, dhe sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e përpunimit të të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.

4. Autoritetet kompetente, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, mund të përdorin rezultatet e përpunimit të të dhënave të pasagjerit vetëm nëse vlerësojnë që përdorimi i tyre shërben për parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen penale të veprave të tjera penale.

Neni 19/6

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave

1. NIP-i shpërndan apo shkëmben, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat e pasagjerit ose rezultatet e përpunimit të tyre me agjenci ndërkombëtare ligjzbatuese, me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje bashkëpunimi, në rastet kur:

a) nga verifikimi apo nga përpunimi i të dhënave të pasagjerit, rezulton se të dhënat janë të nevojshme për autoritetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për parandalimin, zbulimin, hetimin apo ndjekjen penale të veprave penale të përcaktuara në pikën 1, të nenit 19/3, të këtij ligji;

b) autoritetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, kanë paraqitur kërkesë të arsyetuar, që provon se shpërndarja/shkëmbimi i të dhënave është i nevojshëm për të parandaluar kryerjen e veprave penale të përcaktuara në pikën 1, të nenit 19/3, të këtij ligji.

2. Për çdo rast të transferimit ndërkombëtar të të dhënave të pasagjerit ose rezultatet e përpunimit të tyre, NIP-i njofton personin e ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave.

3. Rregulla më të hollësishme për transferimin ndërkombëtar të të dhënave përcaktohen në rregulloren për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.

Neni 19/7

Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, veprimtarinë e grumbullimit, të përpunimit, të shpërndarjes dhe të shkëmbimit të të dhënave të pasagjerit nga NIP-i, si dhe:

a) trajton, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ankesat e paraqitura nga çdo subjekt i të dhënave;

b) verifikon ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave, kryen hetime administrative dhe inspektive, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, me iniciativën e tij ose në bazë të ankesave;

c) me kërkesë të çdo subjekti të të dhënave, jep rekomandime, me qëllim garantimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale;

ç) çdo dy vjet, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, vlerëson prodhimin dhe përdorimin e profileve të riskut dhe të modeleve të kontrollit, të krijuara nga NIP-i.

Neni 19/8

Personi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave

1. Pranë NIP-it caktohet personi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave, përgjegjës për monitorimin e përpunimit të të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit dhe zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Personi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave i komunikon Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës çdo rast të konstatimit të shkeljes së të drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Personi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave gëzon pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve të tij, sipas këtij ligji.

4. Mënyra e funksionimit dhe e bashkëpunimit të personit të ngarkuar për mbrojtjen e pasagjerit me Autoritetin Kombëtar Mbikëqyrës përcaktohet në rregulloren për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.



Neni 19/9

Periudha e ruajtjes së të dhënave

1. Të dhënat e pasagjerit, të transmetuara nga transportuesit ajrorë pranë NIP-it ruhen në bazën e të dhënave të pasagjerit, për një periudhë pesëvjeçare nga transmetimi i tyre.

2. NIP-i, pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, fshin/shkatërron të dhënat e pasagjerit.

3. NIP-i fshin/shkatërron rezultatet e përpunimit të të dhënave të pasagjerit sapo ato nuk i shërbejnë qëllimit të këtij ligji.

4. Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar fshijnë të dhënat e përcaktuara në shkronjën “ë”, të nenit 19/2, të këtij ligji, brenda një afati prej 24 orësh nga transmetimi i tyre, me përjashtim të rasteve kur ruajtja e tyre është e nevojshme për përmbushjen e detyrave ligjore.

5. Autoritetet kompetente ruajnë dhe fshijnë të dhënat e pasagjerit, si dhe rezultatet e përpunimit të tyre, sipas legjislacionit të posaçëm që rregullon veprimtarinë e tyre, si dhe në përputhje me parimet për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Transportuesit ajrorë fshijnë të dhënat, sipas shkronjës “ë”, të nenit 19/2, të këtij ligji, brenda një afati prej 24 orësh nga momenti i mbërritjes së mjetit të transportit.

7. Mënyra dhe procedura që ndiqet për fshirjen/shkatërrimin e të dhënave të pasagjerit apo rezultatet e përpunimit të tyre përcaktohen në rregulloren e përpunimit të të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.

Neni 19/10

Ruajtja e fshehtësisë së të dhënave

1. Të dhënat e pasagjerit, pas kalimit të një periudhe prej gjashtë muajsh nga transmetimi, anonimizohen përmes bërjes së padukshme për një përdorues, të elementeve të mëposhtme të të dhënave, që mund të shërbejnë për të identifikuar drejtpërdrejt subjektin e të dhënave, si më poshtë:

a) emrin/emrat e tjerë, mbiemrin, përfshirë edhe të dhënat e pasagjerëve të tjerë që udhëtojnë bashkërisht dhe rezultojnë në regjistrin e rezervimit të pasagjerit;

b) adresën dhe të dhënat e kontaktit;

c) të gjitha informacionet për mënyrën e pagesës, përfshirë adresën e faturimit, në masën që

mund të shërbejë për të identifikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pasagjerin, të cilit i referohet e dhëna ose ndonjë person tjetër;

ç) informacionin për pasagjerët e shpeshhtë;

d) informacionet e përgjithshme, në masën që mund të shërbejnë për të identifikuar pasagjerin, të cilit i referohen të dhënat e regjistrit të rezervimit të pasagjerit;

dh) informacionin paraprak për pasagjerin, sipas shkronjës “ë”, të nenit 19/2, të këtij ligji.

2. Pas kalimit të periudhës prej gjashtë muajsh, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, dhe anonimizimit të të dhënave, zbulimi i të dhënave të plota të regjistrit të rezervimit të pasagjerit lejohet vetëm kur vlerësohet se zbulimi i tyre i shërben qëllimit të përcaktuar në nenin 19/3, të këtij ligji. Zbulimi i të dhënave bëhet vetëm pas miratimit të kërkesës së titullarit të strukturës nga e cila varet NPDP-ja, nga organi procedues.

3. Në rast të një rreziku real dhe të çastit, për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste apo krime të rënda, titullari më i lartë i strukturës nga e cila varet NIP-i urdhëron zbulimin e të dhënave. Urdhri për zbulimin e të dhënave dërgohet pa vonesë pranë organit procedues, me qëllim vlerësimin e kushteve dhe, sipas rastit, vleftësimin ose jo të tij.

4. Për zbulimin e të dhënave të plota të regjistrit të rezervimit të pasagjerit, pas anonimizimit të tyre, informohet personi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave dhe Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës, të cilit, sipas rastit, mund të bëjnë verifikimin e kushteve për zbulimin e plotë të të dhënave. Mendimi i personit të ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave dhe i Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës përfshihen në kërkesën për zbulimin e të dhënave që i drejtohet organit procedues.

Neni 19/11

Të drejtat e subjektit të të dhënave

1. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kontaktojë personin e ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave, për çdo çështje që lidhet me grumbullimin, shpërndarjen apo përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.

2. Subjekti i të dhënave ka të drejtën e aksesit, të informimit, të korigjimit, të fshirjes së të dhënave, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të drejtën e ankimit dhe të



kompensimit të dëmit, sipas legjislacionit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”.

Neni 4

Në nenin 20, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) të përpunojë të dhënat e pasagjerit, sipas përcaktimeve të kreu II/1 të këtij ligji.”.

Neni 5

Në nenin 21 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Konsiderohen kundërvajtje administrative, nëse nuk përbëjnë vepër penale, veprimet apo mosveprimet e çdo transportuesi ajror që nuk transmeton apo transmeton të dhëna të paplota apo të rreme të regjistrimit të rezervimit të pasagjerit.”.

2. Pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 këtë përmbajtje:

“6. Për kundërvajtjet e parashikuara në pikën 1/1, të pikës 1, të këtij neni, transportuesit ajrorë dënohen me gjobë, nga NIP-i, për çdo udhëtim, nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë për çdo pasagjer, të dhënat e të cilit nuk janë transmetuar ose janë të paplota apo të rreme.

7. Në rastet e shkeljeve të rënda apo të përsëritura të detyrimeve që rrjedhin nga kreu II/1, i këtij ligji, me kërkesën e NIP-it, ndaj transportuesit mund të vendoset pezullimi i përkohshëm ose heqja e licencës së veprimtarisë nga autoritetet përkatëse.”.

Neni 6

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të pikës 8, të nenit 19/2, të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të pikës 6, të nenit 19/2, të këtij ligji.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 5.3.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11448, datë 6.3.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET

Nr. 11448, datë 6.3.2020

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN
E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 22/2020 “Për disa shtesa në ligjin nr. 71/2016 ‘Për kontrollin kufitar’”.

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 22/2020 “Për disa shtesa në ligjin nr. 71/2016 ‘Për kontrollin kufitar’”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**



VENDIM
Nr. 190, datë 4.3.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS BASHKËPUNUESE TË
GUAJANËS, PËR PËRJASHTIMIN NGA
KËRKESAT PËR VIZË PËR MBAJTËSIT
E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE,
PASAPORTAVE TË SHËRBIMIT DHE
PASAPORTAVE TË ZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Bashkëpunuese të Guajanës, për përjashtimin nga kërkesat për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, pasaportave të shërbimit dhe pasaportave të zakonshme, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
**MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS
BASHKËPUNUESE TË GUAJANËS, MBI
PËRJASHTIMIN NGA KËRKESAT PËR
VIZË PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE, PASAPORTAVE TË
SHËRBIMIT DHE PASAPORTAVE TË
ZAKONSHME**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Bashkëpunuese të Guajanës (më poshtë referuar individualisht si

“Palë Kontraktuese” dhe kolektivisht si “Palët Kontraktuese”);

me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ekzistues miqësor, si dhe për të lehtësuar udhëtimin midis dy vendeve, duke e parë atë si një mjet të rëndësishëm për të forcuar lidhjet dhe për të mbështetur zhvillimin në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë;

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qytetarët e secilit prej vendeve, që janë zotërues të pasaportave të vlefshme diplomatike, të pasaportave të shërbimit ose të pasaportave të zakonshme, të lëshuara nga Palët Kontraktuese, përjashtohen nga kërkesat për viza hyrjeje, daljeje ose transiti, përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese për një periudhë jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda gjashtë muajsh brenda periudhës prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh.

Neni 2

Qytetarëve të secilit prej vendeve që kanë ndërmend të qëndrojnë më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë rresht në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, siç përmendet në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, u kërkohet të marrin vizën përkatëse para mbërritjes ose, nëse ndodhen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, të aplikojnë për vizë para skadimit të 90 (nëntëdhjetë) ditëve rresht.

Qytetarët e secilës prej Palëve Kontraktuese, të cilët nuk janë në gjendje të dalin nga territori i Palës tjetër Kontraktuese, brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme (sëmundje ose fatkeqësi natyrore) dhe kanë dokumente ose prova të tjera të besueshme që vërtetojnë rrethana të tilla, mund të aplikojnë pranë autoriteteve përkatëse për lejen e zgjatjes së qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, për një periudhë të përshtatshme, të nevojshme për t’u kthyer në vendin e shtetësisë së tyre ose vendbanimin e tyre të përhershëm.



Neni 3

Qytetarët e secilit vend, në përputhje me nenin 1, mund të hyjnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese ose të dalin nga ai në çdo port ose kufi të hapur për trafik ndërkombëtar për udhëtarët, me kusht që ata të përmbushin kërkesat e ligjeve dhe rregulloreve të vendit tjetër në lidhje me këtë hyrje, lëvizje dhe qëndrim nga të huajt.

Neni 4

1. Qytetarët e secilës Palë Kontraktuese, që mbajnë pasaporta diplomatike, pasaporta shërbimi ose pasaporta të zakonshme, të cilët janë caktuar në misionet diplomatike, konsullore ose përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përjashtohen nga kërkesa për vizë për të hyrë, dalë ose për të kaluar transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, për periudhën e emërimit të tyre.

2. Dispozitat e paragrafit I të këtij neni zbatohen, gjithashtu, edhe për anëtarët e familjeve të tyre që kanë pasaporta të vlefshme diplomatike, pasaporta shërbimi dhe pasaporta të zakonshme.

Neni 5

Qytetarët e secilës Palë Kontraktuese, në rast të humbjes ose të dëmtimit të pasaportave të vlefshme diplomatike, pasaportave të shërbimit ose pasaportave të zakonshme gjatë qëndrimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të dalin nga territori i këtij shteti në bazë të dokumenteve të reja të udhëtimit, të lëshuara nga misioni diplomatik ose konsullor i vendit të shtetësisë së tyre.

Neni 6

Në frymën e ruajtjes së interesave publikë, luftimit të migracionit të paligjshëm dhe përgjigjes së shqetësimeve për sigurinë e të dyja vendeve; të dyja palët, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme, marrin përsipër të bëjnë çmos për të ndaluar çdo person të padëshiruar dhe qytetarë të vendeve të treta të hyjnë në territorin e njëri-tjetrit.

Neni 7

1. Secila Palë Kontraktuese ka të drejtë të mohojë hyrjen në territorin e saj të qytetarëve të Palës tjetër Kontraktuese ose të anulojë ose të shkurtojë qëndrimin e tyre në vend, në rastin kur individit kryen veprime që shkelin ligjet dhe rregulloret e Palës pritëse.

2. Pala tjetër Kontraktuese do të kërkojë daljen pa vonesë dhe formalitete të mëtejshme, të çdo qytetari të Palës tjetër Kontraktuese që ka paraqitur dokumente false ose të falsifikuara pranë autoriteteve kufitare të Palës tjetër Kontraktuese, ose që ka tejkaluar periudhën e lejuar të qëndrimit, ose që ka shkelur rregullat ekzistuese që rregullojnë procedurat e hyrjes dhe të daljes në Palën tjetër Kontraktuese.

Neni 8

1. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë, përmes kanaleve diplomatike, ekzemplarë të pasaportave të vlefshme diplomatike, pasaportave të shërbimit ose pasaportave të zakonshme, të listuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rast të futjes së pasaportave të reja diplomatike, të shërbimit ose të zakonshme të listuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje, ose në raste të ndonjë modifikimi në pasaportat e vlefshme, Palët njoftojnë njëra-tjetrën mbi këto ndryshime dhe shkëmbejnë, përmes kanaleve diplomatike, ekzemplarë të dokumenteve të tilla të udhëtimit jo më vonë sesa 30 (tridhjetë) ditë para hyrjes në fuqi të tyre.

Neni 9

Kjo Marrëveshje nuk ushtron ndikim mbi detyrimin e qytetarëve të secilës Palë Kontraktuese për të respektuar ligjet dhe rregulloret në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 10

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtën e autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese t'i refuzojnë hyrjen ose qëndrimin një mbajtësi të një diplome diplomatike, pasaporte shërbimi ose



pasaporte të zakonshme të Palës tjetër Kontraktuese, siç parashikohet në nenin 1, nëse një person i tillë konsiderohet si i padëshirueshëm ose *persona non grata*.

Neni 11

1. Secila Palë Kontraktuese mund të pezullojë përkohësisht ose plotësisht, ose pjesërisht, zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit publik. Kur njëra Palë Kontraktuese vendos të pezullojë Marrëveshjen, sipas përcaktimeve më sipër, ajo e njollon Palën tjetër Kontraktuese për pezullimin, përmes kanaleve diplomatike të Palës tjetër Kontraktuese, jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë para një pezullimi të tillë.

2. Pala Kontraktuese që vendos të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për arsyet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, e informon në të njëjtën mënyrë Palën tjetër Kontraktuese për rinovimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Palëve Kontraktuese nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet përmes konsultimeve dhe negociatave.

Neni 13

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të ndërsjellë të Palëve Kontraktuese. Çdo ndryshim ose plotësim i kësaj Marrëveshjeje, të miratuar nga Palët, do të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafin I të këtij neni.

Neni 14

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe dhe hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, përmes të cilave Palët Kontraktuese konfirmojnë përfundimin e procedurave të brendshme ligjore, të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Secila Palë Kontraktuese mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë me një njoftim me

shkrim, përmes kanaleve diplomatike, dhe përfundimi do të hyjë në fuqi 90 (nëntëdhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

Në prani të tyre, të nënshkruarit, me autorizimin e duhur nga qeveritë e tyre përkatëse, e nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Bërë në Uashington, më 27 janar 2020, në dy kopje origjinale, secila në shqip dhe në anglisht, me të dyja tekstet autentike. Në rast mospërputhesh në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, epërsi ka teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLICËS SË SHQIPËRISË

Floreta Faber

Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë

PËR QEVERINË E REPUBLICËS
BASHKËPUNUESE TË GUAJANËS

Riyad Insanally

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë

VENDIM

Nr. 191, datë 4.3.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e pronave zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët dhe hartat kadastrale (fragment) që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.



Lista përbëhet nga 6 (gjashtë) fletë inventari dhe 6 (gjashtë) fletë harta kadastrale (fragment).

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave		Identifikoi: Fiorentina Dollani		Lorena Cenaliaj						
Supervizori: Arben Dervishllari,		Pashk Aliaj		Joana Dadaj						
Fusha e përdorimit të pronës: Arkiv		Aprovoi: Ardit Bido								
Nr. Rend.	A			B						
	Zona Kadast.+ Indeksi i hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. Totale e pronës	Nga Sip Totale: Sa ndërtesë	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti Me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti Përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8330 TR; M-10	7/60	Truall+ Ndërtesë	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	4364 m ²	1734 m ²	Institucion publik, Arkiv	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	



HARTE KADASTRALE



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Identifikoi: Lorenc Agalliu, Leonard Durmishi, Silvana Miliqi, Irina Alia, Elona Sherri

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave

Sektori i Përpunimit të Dokumentacionit, Durrës Supervizori: Arben Dervishllari, Pashk Aliaj, Fiorentina Dollani,
Lorena Cenaliaj, Joana Dadaj


Fusha e përdorimit të pronës: Arkiv

Aprovuar: Ardit Bido

Nr.	A			B			C			
	Zona Kadast.+ Indeksi i hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. Totale e pronës	Nga Sip. Totale: Sa ndërtesë	Funksioni për të cilin përdoret pronë	Institucioni/Enti Me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti Përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8515 DR F-13 DR G-13	6/525	Truall+ Ndërtesë	Sektori i Përpunimit të Dokumentacionit Arkiver, Durrës	1458.25 m ²	184 m ²	Përpunim i dokumenteve arkivore	Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave	DPA	



HARTE KADASTRALE
(Fragment)






1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ASHV Elbasan, Berat dhe Korçë		Identifikoi: Ergyseda Shpatfraku, Eriselda Xhoxhi, Petrit Shtama, Raisa Koka		Enkelida Bordini, Fjoralba Vukatana	
Supervizori: Arben Dervishllari, Lirëna Cenallaj		Pashk Atij, Joana Dadaaj		Fiorentina Dollani	
Fusha e përdorimit të pronës: Arkiv		Aprovi: Ardit Bido			

Nr.	A			B			C			
	Zona Kadast.+ Indeksi i hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. Totale e pronës	Nga Sip. Totale: Sa ndërtes ë	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti Me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti Përlorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8522 EL; N-8	3/31	Truall+ Ndërtes ë	Arkivi Shtetëror Vendor, Elbasan; Lgji "Brigada 17 Sulmuese"	643.99m ²	321.11 m ²	Arkiv Shtetëror Vendor	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	DPA	

Unified Notes Page 1

HARTE KADASTRALE (Fragment)






I. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Identifikoi: Eugen Nako, Griselda Brahamaj, Mirela Lipe, Bejko Hibrari
 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
 Valbona Rrapi, Eglantina Dervishi
 Arkivi Shtetëror Vendor Lushnje,
 Supervizori: Arben Dervishllari, Paski Aliaj, Fiorentina Dollani,
 Vlorë dhe Gjirokastrë, Lorena Cenaliaj, Joana Dadaj
 Fusha e përdorimit të pronës: Arkiv
 Aprovi: Ardit Bido

Nr.	A			B			C			
	Zona Kadast.+ Indeksi i hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. Totale e pronës	Nga Sip. Totale: Sa ndërtesë	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti Me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti Përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8571 LU; K,7	18/29	Truall+ Ndërtesë	ASHV Lushnje Lagja "Kongresi i Lushnjes"	958 m ²	470 m ²	Ruajtje, shërbim dokumentash arkivor	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	

HARTE KADASTRALE (Fragment)






1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTORE

Identifikoi: Floralba Mëstatana, Ergyseda Shipatajku, Enkelejda Sejдини .
 Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave
 Vendruajtje Pogradeç
 Supervizori: Arben Dervishaj, Pashë Aliaj, Florentina Dollani,
 Lorena Cenaliaj, Joana Dadaj
 Aprovoji: Andri Bido

Nr.	A			B						
	Zona Kadast.+ Indeksi i hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. Totale e pronës	Nga Sip Totale: Sa ndërtes ë	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti Me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti Përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8582 PG; D-3	003/16	Ndërtes ë	Vendruajtja Pogradeç	211 m ²	178 m ²	Vendruajtje e dokumenteve e arkivore	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	

Unified Notes Page 1

HARTE KADASTRALE (Fragment)






1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave		Identifikoi: Lek Prela		Armir Hoxha		Gjelina Kolbuçaj	
Vendruajtje Rrëshen		Supervizori: Arben Dervishllari,		Dorian Pjetri,		Suada Ndreu	
		Lorena Cenaliaj,		Pashk Aliaj,		Joana Dadaj,	
		Aprovoi: Ardit Bido		Fiorentina Dollani			
Fusha e përdorimit të pronës:							

Nr.	A			B			C			
	Zona Kadast.+ Indeksi i hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. Totale e pronës	Nga Sip Totale: Sa ndërtesë	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti Me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti Përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	3224	2/139	Truall+ Ndërtesë	Vendruajtja Rrëshen	595.91m ²	219.5 m ²	Vendruajtje e dokumenteve e arkivore	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	

HARTE KADASTRALE
(Fragment)



VENDIM
Nr. 192, datë 4.3.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 177, DATË 25.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN ‘RSM’, NË SHTABIN E TRAJNIM-KËSHILLIMIT DHE TË NDIHMËS, NË KUADËR TË INICIATIVËS SË KARTËS SË ADRIATIKUT, NË AFGANISTAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjala e parë e pikës 3, të vendimit nr. 177, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 1 mars 2025.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 194, datë 4.3.2020

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË NDRYSHIMIT NR. 1 TË KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR BY-PASS-in E VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit të ndryshimit nr. 1 të kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për *by-pass*-in e Vlorës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FI N° 82.138 (AL)
Serapis N° 2012-0200

BYPASS-I VLORË

MARRËVESHJE AMENDIMI NR. 1 NË LIDHJE ME KONTRATËN FINANCIARE TË NËNSHKRUAR MË 20 QERSHOR 2014, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE

Luksemburg, 13 janar 2019
Tiranë, 17 janar 2019

KJO MARRËVESHJE LIDHET NDËRMJET:

1. **Republikës së Shqipërisë** (“Huamarrësi”) dhe

2. **Bankës Evropiane të Investimeve** (“Banka”); bashkërisht të referuara si “Palët”.



INFORMACION PARAPRAK

A. Palët kanë lidhur një kontratë financimi në datën 20 qershor 2014 (“**Kontrata Financiare**”).

B. Në vijim të kërkesës së marrë më 26 dhjetor 2018 nga Huamarrësi, Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Amendimi (në vijim e referuar si “Marrëveshja e Amendimit”), me qëllim amendimin e disa termave të Kontratës Financiare.

ËSHTË RËNË DAKORD si më poshtë:

1. INTERPRETIMI

Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Kontratën Financiare kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë Marrëveshje Amendimi, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe.

2. AMENDIMET

Kontrata Financiare ndryshohet siç përcaktohet më poshtë.

2.1 Përkufizimi *Data Përfundimtare e Vlefshmërisë* e Kontratës Financiare do të ndryshojë për t’u lexuar si më poshtë:

“**Data Përfundimtare e Vlefshmërisë**” është 31 mars 2022.

2.2 Neni 1.04B (a)(vii) do të ndryshojë për t’u lexuar si më poshtë “përveç Transhit të parë, dëshmi që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme se Huamarrësi dhe/ose Zbatuesi të kenë shkaktuar, deri në ditën e 180-të që bie pas datës së preferuar për disbursimin, të specifikuar në kërkesën për disbursim, shpenzimet kualifikuese në një sasi të paktën të barabartë me agregatin/totalin e përgjithshëm:

i. 100% (një qind për qind) e shumave të të gjitha transheve të disbursuara më parë; dhe

ii. 80% (tetëdhjetë për qind) të shumës së Transhit për t’u disbursuar 100% (një qind për qind) e shumës së Transhit, nëse ky Transh është Transhi i fundit për t’u disbursuar;”.

2.3 Nenet aktuale 12.01 dhe 12.02 do të zëvendësohen nga nenet e reja 12.01 dhe 12.02:

“12.01 Forma e njoftimit

a) Njoftimet dhe komunikimet e tjera të dhëna sipas kësaj Kontrate duhet të bëhen me shkrim dhe përveç rasteve kur deklarohet ndryshe, duhet të bëhen nga një nënshkruar i autorizuar me anë të shkresës, postës elektronike dhe faksit.

b) Njoftimet dhe format e tjera të komunikimit, për të cilat periudha fikse përcaktohen në këtë kontratë apo që caktojnë periudha detyruese për marrësin, duhet të bëhen me dërgim dorazi, me

postë rekomande (të regjistruar) faks ose postë elektronike. Këto njoftime dhe komunikime do të çmohen të marra nga pala tjetër:

i. në datën e dorëzimit në lidhje me shkresën e dërguar dorazi ose me postë rekomande;

ii. ose me konfirmimin e marrjes në lidhje me transmetimin me faks;

iii. në rast të çdo poste elektronike të dërguar nga Huamarrësi te Banka, vetëm kur të merret njoftimi se është lexuar;

iv. në rast të çdo poste elektronike të dërguar nga Banka te Huamarrësi, në momentin kur dërgohet posta elektronike.

c) Çdo njoftim i dërguar nga Huamarrësi për Bankën me anë të postës elektronike duhet të:

i. përmendë Numrin e Kontratës tek hapësira e caktuar të lëndës; dhe

ii. jetë në formën e një imazhi elektronik të paredaktueshëm (PDF, TIF ose ndonjë formal tjetër i zakonshëm i paredaktueshëm për të cilin është rënë dakord ndërmjet palëve) të njoftimit të nënshkruar nga një nënshkruar i autorizuar, me të drejtën e përbashkët të përfaqësimit të Huamarrësit sipas rastit, bashkëlidhur postës elektronike.

d) Pa ndikuar në vlefshmërinë e njoftimeve apo komunikimeve me postë elektronike apo faks të bërë në përputhje me këtë nen 12.01, njoftimet, komunikimet dhe dokumentet e mëposhtme do t’i dërgohen palës përkatëse edhe me postë rekomande të paktën menjëherë në ditën vijuese të punës:

i. kërkesa për disbursim;

ii. revokimi i kërkesës për disbursim sipas nenit 1.02C;

375	Ramazan	Qani	Shahaj	3436	56/11	110.0	299	32,890	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
376	Sotiraq	Andon	Bello	3436	56/10	537.9	299	160,832	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
377	Dhimo	Koco	Bello	3436	56/8	1705.0	299	509,795	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
378	Pandeli	Koco	Bello	3436	56/7	2122.2	299	634,538	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
379	Mihallaq	Theodhor	Tare	3436	56/6	1100.5	299	329,050	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
380	Lefter	Theodhor	Tare	3436	56/5	1363.0	299	407,537	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
381	Koco	Nikollaq	Tare	3436	56/4	1385.2	299	414,175	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
382	Janaq	Nikollaq	Tare	3436	56/3	1374.8	299	411,065	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
383	Vangjel	Nikollaq	Tare	3436	56/2	1716.9	299	513,353	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
384	Jorgji	Nikollaq	Tare	3436	56/1	1292.9	299	386,577	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
385	Jorgji	Vangjel	Qendro	3436	85/68	518.1	299	154,912	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
386	Aleks	Vangjel	Qendro	3436	85/67	486.9	299	145,583	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
387	Llazar	Vangjel	Qendro	3436	85/66	664.0	299	198,536	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
388	Llambi	Miti	Rezhda	3436	85/65	524.9	299	156,945	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
389	Loni		Kolici	3436	85/64	418.3	299	125,072	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
390	Thoma	Pano	Ciko	3436	85/62	466.2	299	139,394	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
391	Muke	Selim	Baruti	3436	91/36	76.5	299	22,874	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
392	Saliko	Hamza	Baruti	3436	91/35	346.7	299	103,663	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
393	Muhamet	Hamza	Baruti	3436	91/34	578.7	299	173,031	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
394	Perparim	Hamza	Baruti	3436	91/33	843.4	299	252,177	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
395	Bujar	Hamza	Baruti	3436	91/32	492.3	299	147,198	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
396	Gani	Riza	Sulka	3436	91/31	496.8	299	148,543	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
397	Halil	Riza	Sulka	3436	91/30	527.8	299	157,812	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
398	Myfit	Riza	Sulka	3436	91/29	1038.8	299	310,601	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
399	Meleq	Hasan	Demolli	3436	91/28	655.4	299	195,965	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
400	Engjellush	Servet	Peshkopia	3436	91/27	541.2	299	161,819	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
401	Astrit	Servet	Peshkopia	3436	91/26	662.3	299	198,028	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
402	Gezim	Memet	Pellumbi	3436	91/25	735.4	299	219,885	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
403	Agron	Memet	Pellumbi	3436	91/24	744.5	299	222,606	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
404	Ibrahim	Kasem	Kapa	3436	91/23	806.1	299	241,024	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
405	Hytbi	Nazif	Kapa	3436	91/22	1200.1	299	358,830	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
406	Kimet	Nazif	Kapa	3436	91/21	619.4	299	185,201	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



Nr.	PRONAR			Zona kadast.	Nr. i pasurisë	Arë			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi	Vlera në lekë	
407	Muhamet	Mustafa	Kapa	3436	91/20	550.3	299	164,540	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
408	Rami		Manofi	3436	91/19	381.1	299	113,949	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
409	Hysen	Asim	Manofi	3436	91/18	814.6	299	243,565	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
410	Asim	Zalo	Manofi	3436	91/17	860.6	299	257,319	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
411	Agim	Zalo	Manofi	3436	91/16	826.2	299	247,034	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
412	Artur	Zalo	Manofi	3436	91/15	396.8	299	118,643	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
413	Ilias	Istref	Xherau	3436	91/14	856.6	299	256,123	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
414	Hamdi		Xherau	3436	91/42	458.6	299	137,121	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
415	Xhevair		Xherau	3436	91/43	399.1	299	119,331	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
416	Ylvi	Zini	Xherau	3436	91/12	625.4	299	186,995	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
417	Shkelqim	Zini	Xherau	3436	91/11	506.9	299	151,563	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
418	Defrim	Zini	Xherau	3436	91/10	536.5	299	160,414	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
419	Zini	Estref	Xherau	3436	91/9	527.1	299	157,603	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
420	Sali	Ali	Bazellari	3436	91/8	437.8	299	130,902	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
421	Avni	Ali	Bazellari	3436	91/7	418.8	299	125,221	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
422	Muhamet		Bazellari	3436	91/6	529.8	299	158,410	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
423	Ruzhdi	Ali	Bazellari	3436	91/5	534.3	299	159,756	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
424	Albert	Ruzhdi	Bazellari	3436	91/4	959.8	299	286,980	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
425	Enver	Laver	Zenelaku	3436	91/3	539.5	299	161,311	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
426	Mergim	Laver	Zenelaku	3436	91/2	838.9	299	250,831	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
427	Shaban	Zenel	Merolli	3436	86/32	1253.0	299	374,647	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
428	Ziqiri	Shaban	Merolli	3436	86/2	2496.6	299	746,483	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
429	Medi	Seit	Mucka	3436	86/3	1745.7	299	521,964	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
430	Xhevdet	Ali	Bircaj	3436	86/38	2057.5	299	615,193	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
431	Ferit	Zef	Miraka	3436	86/7	1550.0	299	463,450	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
432	Zef	Ferit	Miraka	3436	86/8	2165.4	299	647,455	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
433	Gjin	Zef	Nimani	3436	86/9	2063.8	299	617,076	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
434	Gaspar	Gjin	Nimani	3436	86/10	2352.1	299	703,278	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
435	Salvador	Gjin	Miraka	3436	86/11	1893.3	299	566,097	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
436	Venetik	Veli	Metoxha	3436	86/12	2176.6	299	650,803	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
437	Bujar	Veli	Metoxha	3436	86/13	3206.1	299	958,624	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
438	Mineko	Veli	Metoxha	3436	86/14	2119.8	299	633,820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
439	Mino	Veli	Lamce	3436	86/15	2702.5	299	808,048	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
440	Resmije		Memini	3436	86/16	2397.6	299	716,882	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
441	Sali	Ajçe	Memini	3436	86/17	1907.5	299	570,343	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
442	Zyber	Ajçe	Memini	3436	86/18	2110.1	299	630,920	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
443	Faslli	Telo	Braka	3436	86/19	1963.0	299	586,937	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
444	Mane	Telo	Braka	3436	86/20	1327.3	299	396,863	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



Nr.	PRONAR			Zona kadast.	Nr. i pasurisë	Arë			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi	Vlera në lekë	
445	Enver	Qani	Hasankolli	3436	86/21	1123.1	299	335,807	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
446	Sali		Ndreu	3436	86/36	1129.4	299	337,691	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
447	Osman	Qazim	Ndreu	3436	86/34	1146.0	299	342,654	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
448	Novruz	Halit	Bakollari	3436	86/25	1210.7	299	361,999	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
449	Bajram		Xhaferi	3436	86/27	453.8	299	135686.2	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
450	Liço		Xhaferi	3436	86/28	119.3	299	35670.7	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
451	Myrdar	Ali	Koçiaj	3436	86/29	731.3	299	218658.7	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
452	Astrit	Myrdar	Koçiaj	3436	86/30	822.2	299	245837.8	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
453	Dallendyshe	Hysni	Mema	3436	86/31	618.0	299	184782	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
454	Dashamir Jaup Dauti + 5 bashkëpronarë			3980	19/77	3104.0	684	2123136	Konfirmuar nga ASHK-ja
455	Ramiz	Jaup	Dauti	3980	19/78	1503.0	684	1028052	Konfirmuar nga ASHK-ja
456	Resmi	Jaup	Dauti	3980	19/71	1890.0	684	1292760	Konfirmuar nga ASHK-ja
457	Murat	Xhelat	Murati	1091	110/4	1655.0	742	1228010	Konfirmuar nga ASHK-ja
458	Qazim	Zani	Merko	3980	4/5	5364.0	684	3668976	Konfirmuar nga ASHK-ja
459	Shefqet	Ahmet	Lushakaj	1471	92/16	190.0	699	132810	Konfirmuar nga ASHK-ja
460	Thoma	Jorgji	Tushe	1941	88/1	4412.0	427	1883924	Konfirmuar nga ASHK-ja
461	Kismet	Bejdulla	Morina	1941	84/55	700.0	427	298900	Konfirmuar nga ASHK-ja
462	Ylli	Osmen	Grembi	3980	19/1	553.0	684	378252	Konfirmuar nga ASHK-ja
463	Kismet	Bejdulla	Morina	1941	84/54	1728.0	427	737856	Konfirmuar nga ASHK-ja
464	Shefqet		Lushakaj	1471	91/1	3376.0	699	2359824	Konfirmuar nga ASHK-ja
						699,608.33		342,434,216.43	



VENDIM

Nr. 197, datë 4.3.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 245, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË TË REDUKTUAR, TË SALLËS SË KONCERTEVE TË PALLATIT TË KONGRESEVE, TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës së mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 245, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, viti “2019” zëvendësohet me “2020”.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 198, datë 4.3.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 277, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË SIPËRFAQES TRUALL FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 3 035.6 m², BRENDA TERRITORIT TË PRONËS ME NUMËR RENDOR 90, ME EMËRTIMIN ‘REPARTI USHTARAK NR. 4400 (ISH-SHTABI I KML-së)’, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 277, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Kudo në vendim, emërtesa “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

2. Në fjalinë e parë, të pikës 1, fjalët “... për sistemimin e administratës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në nivel qendror dhe AKU-së, Tiranë, me ambiente pune, në funksion të këtij institucioni ...” zëvendësohen me “... për përdorimin për zyra për administratën e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe për institucionet e varësisë ...”.

3. Ngarkohen ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



VENDIM

Nr. 203, datë 26.2.2020

PËR PROCEDURAT QË PËRDOREN PËR LIDHJEN E KONTRATAVE QË DIKTOHEN NGA INTERESA THELBËSORË TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 79 e vijues të Kodit Civil, të nenit 6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. OBJEKTI, QËLLIMI DHE PARIMET

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i procedurës për lidhjen e kontratave të mallrave, punëve dhe/ose shërbimeve që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit. Qëllimi i këtij vendimi është përdorimi efektiv i fondeve publike dhe të çdo mjeti financiar ose kapital, i të drejtave të lidhura me to, për kryerjen e procedurave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit.

2. Parimet kryesore, mbi bazën e të cilave hartohet ky vendim, janë:

a) parimi i barazisë, me synim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në garë;

b) parimi i sigurimit të përfitimeve maksimale gjatë procedurës së lidhjeve të kontratave për mallra, punë ose shërbime, që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit;

c) parimi i ruajtjes së sigurisë së interesave kombëtarë, duke garantuar sigurinë e informacionit.

II. FUSHA E ZBATIMIT

Ky vendim do të zbatohet për të gjitha procedurat e kontraktimit për mallra, punë dhe shërbime të nevojshme për kontratat që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit. Përpara fillimit të aplikimit të kësaj procedure, rast pas rasti, titullari i autoritetit kontraktor, me urdhër, miraton rrethanat e gjendjes në kushtet e interesave thelbësorë të shtetit dhe domosdoshmërinë e aplikimit të kësaj procedure.

III. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) “Autoritet kontraktor” janë Kryeministri dhe të gjitha ministrat ose institucionet e varësisë të deleguara me vendim të Këshillit të Ministrave.

b) “Mall”, çdo gjë materiale, me vlerë ekonomike.

c) “Punim”, përfundimi i ndërtimit ose i veprave civile, që përmbushin një funksion ekonomik ose teknik.

d) “Zhvillim i pronës publike”, kryerja e punëve dhe shërbimeve për realizimin e një projekti mbi pronën publike, në përputhje me planet rregullatore të miratuara nga organet kompetente që kanë nën administrim zonën ku ndodhet prona.

e) “Kandidat”, një individ, person fizik tregtar, person juridik, ent publik ose organizatë ndërkombëtare, të ftuar për të marrë pjesë në procedurë.

f) “Ofertues”, një individ, person fizik tregtar, person juridik, ent publik ose organizatë ndërkombëtare, që paraqet një ofertë pranë autoritetit kontraktor.

g) “Procedurë konkurruese”, një formë konkurrimi, në të cilën ftohen subjekte, shqyrtohen, vlerësohen dhe seleksionohen të gjitha ofertat e marra zyrtarisht për të zgjedhur ofertën më të mirë për të lidhur kontratën sipas objektit të kontraktimit.

h) “Procedurë e drejtpërdrejtë”, një procedurë, e cila përdoret vetëm në situata të nevojës ekstreme, të shkaktuara nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor ose sipas parashikimeve në këtë vendim.

i) “Dokumentet e procedurës”, dokumentet që autoriteti kontraktor vë në dispozicion të kandidatëve si bazë për përgatitjen e ofertave të tyre.

j) “Fond limit”, vlera monetare ose mjeti tjetër financiar ose kapital, nxjerrë nga buxheti i autoritetit kontraktor ose nën administrimin e autoritetit kontraktor, që është përcaktuar të përdoret për objektin konkret.

k) “Mjet tjetër financiar ose kapital”, vlerësimi fizik i aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejtave mbi to që vendosen si fond në dispozicion për realizimin e shërbimit/punës.



l) “Kontratë”, çdo lloj marrëveshjeje me shkrim, e lidhur midis ofertuesit fitues dhe autoritetit kontraktor.

m) “Pezullim”, ndërprerja e procedurës në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

n) “Anulim”, anulimi i të gjitha veprimeve që lidhen me realizimin e një procedure në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

o) “Rivlerësim”, rishikimi dhe korrigjimi i të metave të konstatuara, pas përfundimit të procesit të vlerësimit.

p) “Komisioni i Vlerësimit”, komisioni që ngrihet me urdhrin e titullarit të autoritetit kontraktor dhe që ngarkohet për marrjen, shqyrtimin dhe për vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit në zbatim të këtij vendimi.

IV. PROCEDURAT PËR LIDHJEN E KONTRATËS

IV.1 Procedura e hapur

Për realizimin e një kontrate që lidhet me interesat thelbësorë të shtetit, autoriteti kontraktor, në çdo rast, kur nuk ndodhet në kushtet e procedurave të tjera të parashikuara në këtë vendim, përdor procedurën e hapur të konkurrimit.

a) Në procedurat e hapura mund të marrin pjesë kandidatë të huaj dhe kandidatë vendas. Dokumentacioni për kandidatët e huaj do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentacioni për kandidatët vendas, nëse ka të tillë, do të jetë gjithmonë në gjuhën shqipe. Specifikimet teknike, mundësisht sa më të përshtatshme me kërkesat kombëtare, duhet të mbështeten në standardet ndërkombëtare ose në standardet që përdoren gjerësisht në tregun ndërkombëtar. Kandidatët do të lejohen të paraqesin ofertat e tyre, si dhe çdo dokument sigurimi që ata mund të paraqesin, në monedhat e tyre kombëtare ose në një monedhë që përdoret gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare, në përputhje me dokumentet e ftesës për ofertë. Kushtet e përgjithshme dhe specifike të kontratës do të jenë të tilla që përdoren gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare.

b) Njoftimi i kandidatëve që ftohen të marrin pjesë në këtë procedurë bëhet nëpërmjet publikimit të ftesës për ofertë në faqen zyrtare të AK-së për një afat kohor 20 ditë kalendarike.

IV.2 Procedura e drejtpërdrejtë

1. Autoriteti kontraktor zgjedh procedurën e drejtpërdrejtë në kushtet e një nevoje urgjente për

mallra, për ndërtime dhe/ose shërbime, e cila është shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonshme jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe koha në dispozicion për zgjidhjen e nevojës urgjente nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave të tjera, të parashikuara në këtë vendim.

2. Autoriteti kontraktor hyn në marrëdhënie dhe kërkon propozim nga kandidati/tët e mundshëm, të identifikuar për ofrimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve si dhe negocion për kushtet e kontratës. Dokumentet për këtë lloj procedure duhet të përmbajnë një përshkrim të qartë për objektin e kontratës, për cilësinë, për sasinë, për kushtet ose për kohën e kërkuar për dorëzim dhe/ose kërkesa të tjera në përputhje me objektin konkret.

IV.3 Procedura që kërkojnë edhe masa të veçanta sigurie

Në rastet kur autoriteti kontraktor do të realizojë një kontratë, e cila shoqërohet me elemente që kërkojnë masa sigurie të veçanta, për hartimin e dokumentacionit, administrimin, publikimin e tij do të aplikohen rregullat e parashikuara në legjislacionin për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale.

V. KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. Me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor urdhërohet ngritja e Komisionit të Vlerësimit.

2. Komisioni i Vlerësimit kryesohet nga nëpunësi autorizues dhe ka në përbërje të tij nëpunës të nivelit drejtues të lartë dhe të mesëm të autoritetit kontraktor. Në rastet e prokurimit që lidhen me zhvillimin e një prone publike, që është në administrim të organeve të varësisë, Komisioni i Vlerësimit duhet të ketë në përbërje të tij përveç sa është përcaktuar në fjalinë e parë të kësaj pike titullarin e organit të varësisë dhe nëpunës të këtij organi. Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të ofertave.

3. Komisioni i Vlerësimit ka këto detyra specifike:

a) të përcaktojë procedurën që duhet ndjekur për realizimin e kontratës dhe ta paraqesë për miratim të titullari i autoritetit kontraktor;

b) mbas miratimit nga titullari i autoritetit kontraktor të procedurës, në varësi të procedurës së përzgjedhur, të hartojë dokumentacionin “Ftesë



për ofertë”, për propozim kandidatëve të mundshëm, me qëllim përgatitjen prej tyre të ofertave. Dokumentacioni i ftesës për ofertë të hartohet në përputhje me rregullat e informacionit të klasifikuar në rastet kur është e aplikueshme. Për përgatitjen e dokumenteve të tenderit në rastet e zhvillimit të procedurave për pasuri që ndodhen në territorin e një shteti tjetër, Komisioni i Vlerësimit mund të asistohet për marrjen e ekspertizave të specializuara nga një konsulent ligjor i vendit ku ndodhet pasuria. Përzgjedhja e konsulentit bëhet nga Komisioni i Vlerësimit me procedurë të drejtpërdrejtë dhe miratohet nga titullari i autoritetit kontraktor përkatës;

c) në varësi të procedurës, të bëjë shpalljen e njoftimit për kryerjen e procedurës në faqen e internetit të autoritetit kontraktor ose të njoftojë ofertuesin/sit e mundshëm duke iu paraqitur ftesën për ofertë;

ç) të shqyrtojë dhe të vlerësojë ofertat e paraqitura nga kandidatët sipas rregullave që do të përshkruhen në vijim të këtij vendimi;

d) të shpallë kandidatin fitues, të negociojë dhe të ndjekë procedurat deri në lidhjen e kontratës;

dh) për zbatimin e shkronjës “d”, mbas shpalljes së kandidatit fitues, Komisioni i Vlerësimit të hartojë projektvendimin për miratimin e kontratës me kandidatin e shpallur fitues. Në rast se kontrata nuk miratohet nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura konsiderohet e anuluar.

VI. VLERËSIMI I OFERTAVE

1. Ofertat dhe dokumentacioni përkatës, i përcaktuar në ftesën për ofertë, paraqiten nga secili kandidat me shkrim, në zarf të mbyllur, në vendin, datën orën e përcaktuar në ftesën për ofertë, dorazi nga përfaqësuesi i kandidatit ofertues.

2. Hapja e ofertave bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave në prani të të gjithë përfaqësuesve të kandidatëve ofertues në vendin, orën dhe datën e caktuar në dokumentet e ftesës për ofertë.

3. Nëse një apo më shumë kandidatë, pas konfirmimit të marrjes dijeni nuk paraqiten në vendin, orën dhe datën e caktuar në ftesën për ofertë, mosparaqitja e tij/tyre nuk pengon zhvillimin e procedurës së hapjes dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e evidenton në procesverbalin e mbledhjes këtë fakt.

4. Në rast të paraqitjes të vetëm një oferte, Komisioni i Vlerësimit vijon procedurën e vlerësimit të saj.

5. Mbas hapjes së ofertave në prani të përfaqësuesve të kandidatëve ofertues Komisioni i Vlerësimit administron ofertat e paraqitura nga kandidatët ofertues dhe tërhiqet për vlerësimin e tyre.

6. Komisioni i Vlerësimit, mbas administrimit të ofertave, cakton një afat për shpalljen e ofertës fituese, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 20 (njëzet) ditë kalendarike nga data e hapjes së ofertës. Afati i shpalljes së ofertës fituese, data, vendi dhe ora e shpalljes u njoftohen me shkrim kandidatëve ofertues që kanë paraqitur ofertë.

7. Komisioni i Vlerësimit vlerëson dhe i krahason ofertat (kuotimet) e vlefshme, në përputhje me kriteret e vlerësimit, të përcaktuara në dokumentet e ftesës për ofertë, me qëllim që të përcaktojë ofertën ose kuotimin fitues. Vlerësimi bëhet mbi sistem pikësh, të cilat përcaktohen në ftesën për ofertë. Oferta ose kuotimi fitues do të jetë ajo që, në bazë të kriterëve të vlerësimit, merr më shumë pikë. Komisioni, në vendimin përkatës për vlerësimin dhe për klasifikimin e ofertave, mbështetur në pikët e marra, i rendit në klasifikim ofertat (kuotimet) dhe ofertuesit e tyre respektivë, duke filluar nga oferta (kuotimi) fituese dhe duke vazhduar me radhë me të gjitha ofertat (kuotimet) e tjera, përfshirë dhe ato që nuk janë kualifikuar. Ky vendim nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe në të mund të shprehen votat kundër, qëndrimet, mendimet, pretendimet dhe argumentet për to të anëtarëve, në rast se ka të tilla. Në rast se, pas vlerësimit të ofertave tekniko-ekonomike, rezultojnë oferta pretendente të barabarta, oferta fituese do të përcaktohet nga shorti i hedhur ndërmjet ofertuesve që kanë paraqitur këto oferta të barabarta. Në përfundim të kësaj faze, kryetari i Komisionit të Vlerësimit ka për detyrë të paraqesë te titullari i autoritetit kontraktor një informacion përmbledhës për të gjithë procedurën e kryer, si dhe argumentimin për përzgjedhjen e ofertës fituese.

8. Procedura e vlerësimit anulohet dhe përsëritet, (nëse është rasti), në rastet kur:

a) nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm i anëtarëve të komisionit (jo më pak se pesë vetë);

b) asnjë kuotim ose ofertë e sjellë nuk plotëson kërkesat dhe/ose specifikimet teknike të kërkuara.



9. Procedura pezullohet nga titullari i autoritetit kontraktor në rastin e paraqitjes së një ankese nga ndonjëri prej kandidatëve ose ofertuesve. Në këtë rast, titullari ngre një komision për shqyrtimin e ankesës, i cili duhet të dalë me vendim brenda 5 (pesë) ditëve.

10. Në rastet kur nga komisioni i shqyrtimit të ankesave konstatohen parregullsi, të meta, mangësi ose shkelje në procedurë, titullari ia kthen Komisionit të Vlerësimit për rivlerësim.

11. Kur kandidati do të realizojë një pjesë të objektit me nënsipërmarrje, kjo mund të pranohet nga Komisioni i Vlerësimit me kusht që të jetë lidhur një kontratë e noterizuar (përpara datës së hapjes ose pranimit të ofertave ose kuotimeve) ndërmjet kandidatit dhe nënsipërmarrësit, ku të jetë parashikuar ajo pjesë e objektit që do të realizohet nga nënsipërmarrësi.

12. Kryetari i Komisionit të Vlerësimit i paraqet titullarit informacionin përmbledhës. Ky informacion shoqërohet me raportin përmbledhës, si dhe me vendimin e komisionit për klasifikimin e ofertave dhe për përzgjedhjen e ofertës fituese. Titullari i autoritetit kontraktor, në bazë të dokumentacionit të lartpërmendur, gjykon nëse është e nevojshme të kërkohet për shqyrtim i gjithë dokumentacioni i procedurës. Nëse gjykohet i rregullt, brenda afatit prej 2 (dy) ditësh nga marrja e vendimit të komisionit, titullari i autoritetit kontraktor miraton ofertën fituese.

13. Mbas miratimit nga titullari i autoritetit kontraktor, oferta e shpallur fituese u njoftohet kandidatëve ofertues me shkrim, të cilëve u njoftohet e drejta për ankim ndaj vendimit të Komisionit të Vlerësimit. Afati i ankimit është pesë ditë nga data e njoftimit.

14. Komisioni i Vlerësimit shqyrton ankesat brenda afatit 5-ditor nga data e paraqitjes së tyre dhe njofton ministrin përgjegjës për rezultatet e vlerësimit të ankimit.

15. Mbas përfundimit të procedurës së ankimit, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron Komisionin e Vlerësimit për negocimin e kontratës me kandidatin fitues.

16. Pas negocimit, kontrata së bashku me relacionin përkatës i dërgohet titullarit të autoritetit kontraktor për miratim. Në rast se ofertuesi fitues nuk pranon të lidhë kontratë dhe tërhiqet, kjo dokumentohet dhe shpallet fituese oferta e klasifikuar e dyta. Në rast se edhe ofertuesi i

klasifikuar i dyti nuk pranon të lidhë kontratë, atëherë procedura anulohet.

17. Kontrata me kandidatin e shpallur fitues nënshkruhet nga titullari i autoritetit kontraktor përgjegjës ose i deleguari prej tij.

VII. MIRATIMI I KONTRATËS

1. Kontratat, që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit pas nënshkrimit të tyre, do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kontrata do të hyjë në fuqi pas këtij miratimi. Ky kusht do të jetë i specifikuar edhe në kontratën e nënshkruar ndërmjet palëve dhe në dokumentet e procedurës garuese.

2. Në rastet kur kontrata nuk miratohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura do të quhet e anuluar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM Nr. 204, datë 9.3.2020

PËR MARRJEN E MASAVE PËR NGRITJEN E INFRASTRUKTURËS PËR SHËRBBIMIN E KARANTINËS DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Shtëpisë së Pushimit të Ushtarakëve të FARSH-it, prona nr.231, me emërtim “Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve”, me vendndodhje në Plepa, Durrës, si strukturë për shërbimin e karantinës, në funksion të marrjes së



masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga COVID-19.

2. Caktimin e Ministrisë së Mbrojtjes si autoritet kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit, si më poshtë vijon:

a) rikonstrukcion të objektit prona nr. 231, me emërtim “Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve”, me vendndodhje në Plepa, Durrës, për përshtatje si infrastrukturë karantine;

b) blerje mallrash/pajisjesh për përshtatjen e dhomave për nevoja të karantinës;

c) sigurimin e ushqimit të gatuar sipas nevojave;

ç) sigurimin e shërbimit të lavanderisë.

3. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në artikullin buxhetor 602, “Mallra dhe shërbime”, dhe në artikullin buxhetor 231, “Shpenzime kapitale”, i shtohet, përkatësisht, fondi prej 13 824 000 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet e katër mijë) lekësh dhe 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekësh.

4. Efektet financiare, sipas pikës 3, të këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2020.

5. Ministria e Mbrojtjes të koordinojë punën me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përcaktimin e kushteve/kërkesave për funksionimin optimal të objektit të caktuar si infrastrukturë karantine.

6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë të gjitha masat për të siguruar shërbimin shëndetësor dhe psikosocial për personat që vendosen në karantinë, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 205, datë 9.3.2020

PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIN 2020, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE, PËR
MARRJEN E MASAVE PËR
PLOTËSIMIN E NEVOJAVE
PARAPRAKE PËR INFEKSIONIN E
SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, i shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga COVID-19, i ndarë, përkatësisht:

- 200 000 000 (dyqind milionë) lekë në kategorinë e shpenzimeve kapitale;

- 200 000 000 (dyqind milionë) lekë në kategorinë e shpenzimeve korrente.

2. Efekti financiar, prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



URDHËR
Nr. 122, datë 26.2.2020

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLEVE
PËR MASAT NDAJ *CORONAVIRUS*-it
NGA QENDRA KOMBËTARE E
URGJENCËS MJEKËSORE**

Mbështetur në nenin 1, në nenin 4, pika “b”, në nenin 8, pikat “i” dhe “ë”, të ligjit nr. 147/2014, “Për shërbimin e Urgjencës Mjekësore, për kufizimin e përhapjes së infektimit nga *Coronavirus*-i, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të stafit mjekësor dhe të popullatës,

URDHËROJ:

1. Miratimin e protokolleve të QKUM-së për masat ndaj *Coronavirus*-it, sipas dokumentit që i bashkëlidhet urdhrimit.

2. Ngarkohet stafi i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore për zbatimin e këtyre protokolleve.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ndjekjen e zbatimit të këtyre protokolleve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSMINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Mira Rakacolli**

Protokolli i veprimit për personelin e Njesisë së Koordinimit të Urgjencave mjekësore dhe Autoambulancave në terren

Njësia e Koordinimit merr thirrje nga 127-ta, thirrje që mund të vijë nga:

1. qytetarët;
2. mjek familjeje;
3. qendra shëndetësore;
4. spitale rajonale/bashkiake të cilat kërkojnë të bëjnë transport dytësor të pacientëve suspekt/konfirmuar me infeksion nga 2019-nCoV;
5. mision në të cilin nuk kemi dyshime për raste të kontaminuara ose epidemia e gripit;
6. nëse do të kemi probleme në komunikimin me pacientët kinezë të cilët mund të kërkojnë ndihmë te 127-ta, kërkohet ndihma e Ambasadës Kineze.

1. Thirrje të ardhura nga qytetarët

Në rast 2019-nCoV suspekt pas intervistës telefonike të qytetarëve, infermieri i vlerësimit njofton menjëherë mjekun primar i cili konfirmon suspektin dhe aktivizon misionin.

Kryhet hospitalizimi i pacientit, pavarësisht gravitetit të kuadrit klinik nga ekipi i terrenit.

- Mjeku primar njofton drejtorin e QKUM-së.
- Mjeku primar njofton Spitalin Infektiv.
- Mjeku primar njofton mjekun *on-call* të ISHP-së.
- Mjeku primar njofton spitalin rajonal.
- Mjeku primar regjistron rastin suspekt te regjistri pranë NJK-së.

Pacientët në moshë madhore

Në raste të tilla, misioni do t'i komunikohet ekipit mjekësor më të afërt duke i komunikuar KODIN KORONA, që do të thotë ekipi mjekësor duhet të marrë masat, sipas protokollit 2019-nCoV.

Në rastet kur pacienti është në gjendje kritike për jetën ai do të transportohet në TERAPI INTENSIVE ose në urgjencën e spitalit përkatës.

Nëse pacienti nuk është në gjendje kritike për jetën do të hospitalizohet në urgjencën e spitalit përkatës ose në spitalin infektiv në QSUT.

Të gjitha rastet që nuk janë kritike për jetën do të referohen dhe transportohen për në QSUT, në spitalin infektiv.

Pacientët pediatrikë

Ne raste të tilla, misioni do t'i komunikohet ekipit mjekësor më të afërt duke i komunikuar KODIN KORONA, që do të thotë ekipi mjekësor duhet të marrë masat sipas protokollit 2019-nCoV.

Në rastet kur pacienti është në gjendje kritike për jetën ai do të transportohet në TERAPI INTENSIVE ose në urgjencën e spitalit përkatës.

Nëse pacienti nuk është në gjendje kritike për jetën do të hospitalizohet në urgjencën e spitalit përkatës ose në spitalin infektiv në QSUT.

Të gjitha rastet që nuk janë kritike për jetën do të referohen dhe do të transportohen për në QSUT, në spitalin infektiv.

Pacienti pediatrik do të transportohet në urgjencat e spitaleve rajonale, në pediatri ose destinacioni i tij do të përcaktohet pas konsultimit të mjekut primar me drejtorin e QKUM-së, me urgjencën e spitalit përkatës, me spitalin infektiv të QSUT-së dhe me mjekun *on-call* të ISHP-së.

Në rast se prindi ose përgjegjësi ligjor i pacientit refuzon transportin në spital, do të detyrohet sipas



ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”.

2. Telefonata të bëra nga mjeku i familjes

Mjeku i fëmijës mund të gjendet në një nga këto situata:

- në shtëpinë e pacientit të dyshuar;
- të ketë marrë një telefonatë nga pacienti i dyshuar;
- pacienti të jetë paraqitur në qendrën shëndetësore të mjeku i familjes.

A. Në rastin kur mjeku i familjes shkon në banesën e pacientit, NJK aktivizon misionin si më sipër dhe do t'i rekomandojë mjekut t'i vendosë menjëherë një maskë kirurgjikale pacientit të dyshuar.

B. Mjeku NJK do të vendoset në kontakt telefonik me pacientin e dyshuar. Nëse nga mjeku i NJK-së do të konfirmohet si rast i dyshuar, do të aktivizohet një mision si më sipër.

C. Nëse pacienti do të paraqitet në qendrën shëndetësore, atëherë do të aktivizohet menjëherë një mision si më sipër, duke i kërkuar mjekut t'i vendosë një maskë pacientit nëse është e mundur dhe të ruajë distancën prej një metër.

3. Transferimi i pacientëve suspekt ose të konfirmuar me 2019-nCoV nga spitalet rajonale në Spitalin Infektiv në QSUT

Në këto raste, NJK-ja do të aktivizojë misionin sipas protokollit, duke lajmëruar spitalin/repartin e destinacionit, përveçse kodin e nisjes dhe KODIN KORONA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE

Triazhi telefonik për rastet e dyshimta me 2019-nCoV në aeroport, porte dhe pikat kufitare në Republikën e Shqipërisë

Aeroporti/porti/pika kufitare _____
Vendi i origjinës së udhëtimit _____
Vendi tranzit _____
Numri i udhëtarëve në bord avioni/autobusi/makine me personin/at e sëmurë _____

Të dhënat personale

Emri _____
Mbiemri _____
Datëlindja _____
Gjinia _____
Adresa _____
Rezidenca _____
Vendqëndrimi (bashkia, komuna, adresa) në Shqipëri _____
Motivi udhëtimit _____
Nr. i telefonit _____

Triazhi telefonik për rastet e dyshimta me 2019-nCoV

Temperaturë Po Jo Nuk dihet
Ethe Po Jo Nuk dihet
Djersitje Po Jo Nuk dihet
Të vjella Po Jo Nuk dihet
Diarre Po Jo Nuk dihet
Vështirësi në frymëmarrje Po Jo Nuk dihet
Kollë Po Jo Nuk dihet
Rinit (sekrecione) Po Jo Nuk dihet



Teshtimë Po Jo Nuk dihet
 Dhembje koke Po Jo Nuk dihet
 Lodhje Po Jo Nuk dihet
 Të tjera _____

Lëvizja e pacientit në muajin e fundit

Vendi i qëndrimit _____
 Kohëzgjatja e qëndrimit _____
 Udhëtimet e fundit (vendet ku ka qene brenda 14 ditëve të fundit) _____
 Vendi nga vjen 24 orë përpara mbërritjes _____


Regjistri i rasteve të dyshuara me 2019-nCoV

Data	Ora e thirrjes	Mjeku primar	Mjeti i dërguar	Shtruar në spital PO/JO	Nr. i skedës



SKEMA PËRMBLEDHËSE

INDIKACIONE OPERATIVE PËR (2019 – nCoV) URGJENCA KOMBËTARE 127, SHQIPËRI



*Lista e spitaleve infektive dhe repartet e pediatriisë



**Protokolli 2019-nCoV për personelin
mjekësor**

Në rastet suspekt ose konfirmuar për infeksion nga 2019-nCov është e rëndësishme:

1. Të përdoret PPE (*Personal Protection Equipment*) MBP (Mjete Mbrojtjeje Personale):

a) maska mbrojtëse;
b) maskë mbrojtëse faciale;
c) maskë mbrojtëse FFP2 ose FFP3 (në rast manipulimesh, si aerosol ose përdorimi i ventilatorëve);

d) xhakete mbrojtëse e papërshkrueshme me mëngë të gjata jo sterile;

e) doreza të gjata josterile.

2. T'i japim dhe t'i kërkojmë pacientit të vendosë maskë kirurgjikale.

3. Të bëhet një higjienë e duarve e shoqëruar nga përdorimi e ujit dhe sapunit dhe përdorimi i detergjentit me bazë të alkoolit (duart duhet të lahen para dhe pas kontaktit me pacientin, pas çdo manipulimi që mund të shkaktojë kontaminimin dhe pas heqjes së dorezave).

4. Ndjekja korrekte e asgjësimit të PPE-ve/MBP-ve të cilët janë përdorur në kontenedorët përkatës në urgjencat mjekësore të spitaleve ose në repartet e sëmundjeve infektive.

5. Të evitohet kontakti me çdo sipërfaqe të kontaminuar.

6. Të qëndrohet nëse është e mundur një metër nga pacienti.

7. Të sigurohet një ajrosje e duhur e autoambulancës ose mjetit i cili ka transportuar pacientin suspekt gjatë fazës së dezinfektimit.

8. Të përdoren mjete njëpërdorimëshe, nëse është e mundur ose të dezinfektohen instrumentet me alkool etilik 70%.

9. Të bëhet një dezinfektim i sipërfaqeve të autoambulancës ose i mjetit të transportit me ipoklorit natriumi, pasi është bërë transporti.

**URDHËR
Nr. 123, datë 26.2.2020**

**PËR NJË SHITESË NË URDRIN NR.
632, DATË 29.8.2018, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË SËMUNDJEVE INFEKTIVE,
TË DETYRUESHME PËR T’U
RAPORTUAR NGA INSTITUCIONET
SHËNDETËSORE, PUBLIKE OSE
PRIVATE TË TË GJITHA NIVELEVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar dhe të nenit 29, pika 6, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 632, datë 29.8.2018, “Për miratimin e listës së sëmundjeve infektive, të detyrueshme për t’u raportuar nga institucionet shëndetësore, publike ose private të të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë”, të shtohet pika si më poshtë:

Në germën “A”, “Lista e sëmundjeve infektive dhe shkaktarëve të tyre”, të shtohet numri rendor, “79. **COVID-19** (Koronavirusi) shkaktohet nga virusi SARS-COV2. Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Instituti i Shëndetit Publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**



URDHËR
Nr. 142, datë 3.3.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Arben Dervishllari, drejtor i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 4.3.2020 deri në datën 6.3.2020.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Financave dhe Shërbimeve apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Arben Dervishllari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
I ARKIVAVE
Ardit Bido

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë